



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 385 /2023

Në bazë të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale numër Nr. 03/L-40 neni 43, nenit 31 të Statutit të Komunës së Hanit të Elezit, bëjë këtë:

F T E S Ë

Ftoheni që të merrni pjesë në mbledhjen e katër -IV- të rregullt për vitin 2023 të Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet me datë 27.04.2023 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2023.
3. Rregullorja për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Hanit të Elezit.
4. Kërkesa e znj. Hanushe Dernjani për ndërrim destinimin e pronës.
5. Informatë për ndarjen e bursave.
6. Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2023 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.
7. Të ndryshme.

Bashkë me ftesën ju dërgojmë:-

- Procesverbalin nga mbledhja e kaluar.
- Materialin e raportit financiar për periudhën Janar – Mars 2023.
- Materialin e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Hanit të Elezit.
- Materialin e kërkesës së znj. Hanushe Dernjani për ndërrim destinimin e pronës.
- Materialin e informatës për ndarjen e bursave.
- Materialin e raportit financiar për periudhën Janar – Mars 2023 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.

Hani i Elezit
Data:-18.04.2023





Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 3387 /2023
Data: 18.04.2023

PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbali nga mbledhja e tretë -III- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 30.03.2023 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: **Mehmet Ballazhi** (Kryetar i Komunës), **Natyra Kalisi** (Drejtoresh e Administratës), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik), **Kimete Kuka -Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Nexhmedin Daci** (Drejtor për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport), **Arsim Dernjani** (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), Përfaqësuesi i OSB-së, **Ajete Berisha** (Udhëheqëse e Personelit), **Sara Berisha** (Asistente e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës). Kryesuesi pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të kuvendit, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Kuvendit të Komunës.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Propozim vendim për formimin e komisionit për plotësimin dhe ndryshimin e Statutit të Komunës.
3. Rregullorja për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Hanit të Elezit.
4. Raporti i progresit të zbatimit të rekomandimeve të auditorit për vitin 2021.
5. Raporti i punës së komitetit për komunitete për vitin 2022.
6. Raporti i punës së katër komiteteve konsultative për vitin 2022.
7. Propozim vendim për miratimin e iniciativës për bashkëpunim ndërkomunal ndërmjet komunave të regjionit Gjilanit dhe Ferizajt në fushën e menaxhimit të integruar të mbeturinave.
8. Propozim vendim për shpalljen me interes të përgjithshëm të parcelave kadastrale.
9. Informatë për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2022.
10. Informatë për aktivitetet e këshillave të fshatrave të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2022.
11. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- a keni ndonjë vërejtje rreth procesverbalit, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUAR PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Propozim vendim për formimin e komisionit për plotësimin dhe ndryshimin e Statutit të Komunës.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Hisni Luri thekson:- ne kemi kërkuar që të ndahet drejtoria e arsimit veçmas nga kultura rinia dhe sporti për shkak të funksionalizimit të qendrës së kulturës sepse po e kemi të pa mundur me funksionalizuar në mënyrën e duhur për shkak të angazhimeve të shumta që janë te pjesa e kulturës që janë të përfshira OJQ-të, Sportet . Nëse mbahet ndarja do të bëhet një menaxhim më i mirë i Shtëpisë së Kulturës dhe aktivitete kulturore që bëhen . Për me qenë më efikase drejtoria e arsimit po e shohim si me urgjencë ndarjen e kësaj drejtorie.

Hyriete Isufi thekson:- a janë bërë planet se si ka me funksionuar sepse sa më shumë të ndahen punët dihet se kush është përgjegjës i një pune dhe punët kryhen më mirë .

Zaim Bela thekson:- a do të bëhet drejtori në veti apo do të shtohet një sektorë për Rini, Sport dhe Kulturë apo do të jetë drejtori në veti për shkak se duhet ta ketë stafin e vetë . Unë propozojë që më mirë të caktohet një zyrtarë që me u marr vetëm me ato aktivitete se me shtuar drejtori për shkak se si komunë e vogël po na bëhen nëntë drejtori e ndoshta na behet e tepërt

Refet Kalisi thekson:- propozimet që ishin dhënë për këtë drejtori shihet e kishte kompetenca të mëdha por kërkoj sqarim për çështje të buxhetit .

Resul Suma thekson:- a e keni shikuar çështjen e ligjshmërisë dhe kur planifikohet të hynë në fuqi.

Mehmet Ballazhi thekson:- nuk është çështje e punësimit por është një drejtori që e ka një individ të caktuar dhe kjo bëhet me buxhetin e vitit të ardhshëm më të cilën në aspekt ligjorë jemi konsultuar dhe jam i bindur që ka me funksionuar më shumë se kur është bashkë . Për me bërë sektor këtë drejtori nuk na lejohet për shkak se kemi numër të kufizuar të stafit dhe kjo është mënyra që për me ndarë si drejtorie që është brenda Ligjit por me këtë ndryshime statutare që mendoj që ka me funksionuar më mirë se është tash.

Hisni Luri thekson:- ne po planifikojmë me i bërë ndryshimet në mënyrë që vitin e ardhshëm me i planifikuar mjetet financiare edhe për këtë drejtori.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROPOZIIMI PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E STATUTIT TË KOMUNËS

3.Rregullorja për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Hanit të Elezit.

Kryesuesi thekson:- materialin e keni para vetës dhe nëse keni ndonjë diskutim mund të parashtroni.

Arsim Dernjani thekson:- kemi bërë një analizë me kompaninë NPL Pastrimi dhe kemi ardhur në përfundim që të propozojmë për një ngritje prej 30% për shkak të çmimeve që janë rritur duke filluar prej derivateve, deponia dhe çmimet e tjera.

Hyriete Isufi thekson:- kur planifikohet me u zbatuar ngritja.

Mehmet Ballazhi thekson:- kemi pasur takime edhe në nivel të kryetarëve për menaxhimin e mbeturinave dhe jemi të fundit që po e bëjmë këtë ngritje të çmimeve dhe kjo është propozuar për shkak të ngritjeve të çmimeve të deponisë dhe shpenzimet të cilat janë për nevoja të kompanisë . Komunitet tjerë ngritje kanë bërë më shumë por ne kemi shkuar në minimum. Në fuqi rregullorja hynë nga momenti që na konfirmohet ligjshmëria nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Sherif Berisha thekson:- sa i përket rregullores për menaxhimin e mbeturinave qëndrimi i Lëvizjes Vetëvendosje është që çmimi të mbetet pesë euro por edhe në komitet për Politikë e Financa kam kërkuar që me ju ngritur pagat punëtorëve të kompanisë Pastrimi.

Mehmet Ballazhi thekson:- ne nuk po bëjmë politikë këtu për shkak se jemi të gjithë qytetarë këtu që kemi me i paguar ato taksa e që edhe unë jam njëri prej atyre dhe ne kemi hezituar dhe rezistuar që mos me i ngritë e ndoshta mund ta zvogëlojmë por nuk do të jetë funksionale kompania për menaxhimin e mbeturinave edhe pse komuna e mbështetë me subvencione për shërbime , mirëpo është e domosdoshme sepse nga një herë nuk varet shumë prej neve por varet prej kompanisë regjionale ku bëhet grumbullimi i mbeturinave. Ngritjen e pagave të NPL Pastrimi është bordi që e përcakton në bazë të të hyrave sepse komuna nuk ndërhyrë në rritje të pagave pavarësisht se jemi themelues si kuvendë.

Resul Suma thekson:- ngritja e çmimeve në shumë prej 30 % mu dukë që është shumë dhe llogaritjet të cilat i kam bërë te plani për menaxhimin e mbeturinave për vitin 2023-2027 del që janë 1446 ekonomi familjare dhe nëse llogaritet në shumë prej pesë euro del që është 86 760 € , ndërsa nëse llogaritet nga 6.50 € del që është 112 800 € që i bien një dallim në shumë prej 26 000 € dhe nëse i dëmtojmë qytetarët me këtë shumë nuk më duket që është e arsyeshme.

Kryesuesi thekson:- të gjithë jemi që mos me u ngritur , mirëpo duke i parë rrethana që ka ngritje të çmimeve të derivateve, ngritje të çmimit të deponisë dhe unë mendoj se është minimumi i kësaj ngritje të çmimit.

Mehmet Ballazhi thekson:- nëse është llogaritur se sa mjete financiare grumbullohen duhet të llogaritet edhe sa shpenzohet në tonë për deponin që dërgohen mbeturinat pastaj çështja e derivateve. U diskutua çështja e ngritjes së pagave edhe kompani e ka një plan të biznesit për këtë çështje dhe jemi dëshmitarë në Komunë e Hanit të Elezit që menaxhimi i mbeturinave po bëhet në mënyrën më të mundshme dhe është shumë më mirë se në komunitet tjerë.

Refet Kalisi thekson:- sa i përket çmimit për mbeturinat unë do të votoj pro këtij që të bëhet ngritja sepse nëse nuk bëhet ngritja e çmimeve nuk mundet me funksionuar kompania.

Nora Xhoni thekson:- e di që qytetari nuk duhet të dëmtohet por për 1.50 € me u diskutuar katërdhjetë minuta dhe ju e dini të gjithë që paga na u ngritë dhe ndryshime kanë ndodhur dhe u dhanë arsyetimet për çështjen e ngritjes dhe mendoj që 1.50 € nuk është shumë .

Hanumshahe Dibrani thekson:- ata të cilët janë me social a egzistojnë mundësia me u liruar nga pagesa.

Mehmet Ballazhi thekson:- nuk kemi asnjë mbështetje ligjore që mundemi me liruar dikend prej pagesës sepse asnjë ligj nuk na lejon me i fal borxh askujt.

Sherif Berisha thekson:- kemi kërkuar që t'i bëhet auditim kësaj kompanie dhe ende nuk i është bërë dhe kërkoj t'i bëhet.

Malik Berisha thekson:- këta që janë me kontratë të veçantë kompania Sharrcem dhe Terminali doganorë si do ta kenë çmimin.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 13 për, 1 kundër, 1 abstenim.

U VOTUA RREGULLORJA PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË KOMUNËN E HANIT TË ELEZIT QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

4.Raporti i progresit të zbatimit të rekomandimeve të auditorit për vitin 2021.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- për vitin 2021 kemi pasur nëntë të gjetura ku prej tyre gjashtë janë zbatuar plotësisht ndërsa, tre të tjera janë pjesërisht të zbatuara. Çështja e parë ka të bëjë me klasifikimi i shpenzimeve në kategorinë ekonomike jo përkatëse dhe gjatë vitit 2022 jemi munduar që pagesat të ekzekutohen në bazë të kodeve ekonomike të duhura dhe ky rekomandim është zbatuar plotësisht. Çështja e dytë ka të bëjë me mangësinë shpjeguese të pasqyrave vjetore financiare dhe kjo është zbatuar plotësisht. Çështja e tretë ka të bëjë në parregullsi në procedurat e rekrutimit të personelit dhe kjo është zbatuar plotësisht. Çështja e katërt ka të bëjë në mangësi në vlerësimin e tenderëve dhe kjo është zbatuar plotësisht. Çështja e pestë parregullsi në procedurat e subvencionit të projekteve dhe kjo është zbatuar plotësisht. Çështja e gjashtë ka të bëjë me nënshkrimi i kontratës publike pa zotim paraprak të mjeteve në SIMFK, si dhe lëshimi i urdhër blerjeve pas skadimit të kontratave dhe kjo e gjetur është pjesërisht e zbatuar. Çështja e shtatë ka të bëjë me parregullsinë në menaxhimin e pasurisë jo financiare dhe kjo është zbatuar plotësisht. Çështja e tetë ka të bëjë me rritjen e llogarive të arkëtueshme dhe kjo është zbatuar pjesërisht. Çështja e nëntë vonesa në regjistrim dhe pagesa të obligimeve dhe kjo është zbatuar pjesërisht.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të parapri sipas agjendës.

5.Raporti i punës së komitetit për komunitete për vitin 2022.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RAPORTI I PUNËS SË KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN 2022

6. Raporti i punës së katër komiteve konsultative për vitin 2022.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RAPORTI I PUNËS SË KATËR KOMITETEVE KONSULTATIVE PËR VITIN 2022

7.Propozim vendim për miratimin e iniciativës për bashkëpunim ndërkomunal ndërmjet komunave të regjionit Gjilanit dhe Ferizajt në fushën e menaxhimit të integruar të mbeturinave.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Arsim Dernjani thekson:-përveç materialit të cilin e kam përcjell diçka të veçantë nuk kam.

Refet Kalisi thekson:- çka përfitojnë qytetarët sa nga kjo marrëveshje që do të bëhet me komunat e Regjionit

Mehmet Ballazhi thekson:- është në nivelin regional dhe është ligjore , ndoshta ndonjë herë nuk përfitojmë por është ligjore. Edhe prej kompanisë së “Bifurkacionit” nuk jemi duke përfituar asgjë e ndoshta më mirë e kishim menaxhuar si komunë se kishim dituar çka me vepruar sepse një kërkesë shumë e vogël por procedurat burokratike por është ligjore.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROPOZIM VENDIMI PËR MIRATIMIN E INICIATIVËS PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMUNAL NDËRMJET KOMUNAVE TË REGJIONIT DHE FERIZAJIT NË FUSHËN E MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETURINAVE

8. Propozim vendim për shpalljen me interes të përgjithshëm të parcelave kadastrale.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sherif Berisha thekson:- kërkoj që kjo pikë të hiqet nga rendi i ditës për shkak se asnjë anëtarë i kuvendit të komunës nuk ka informacion se pse komuna i ka shpallur me interes të përgjithshëm këto prona.

Nexhmedin Daci thekson:- me numrin rendorë një e keni një parcelë te stadiumi i futbollit “Suad Brava” për shkak se kur janë shpall me interes të përgjithshëm këto prona kjo parcele nuk është përfshirë në vendimin për shpalljen me interes të përgjithshëm dhe nëse kalon ky vendim duhet të bëjmë kërkesë në Qeveri me shpronësuar këtë parcelë për shkak se me atë pronë menaxhon AKP-ja. Me numrin rendorë dy i keni tri parcele të cilat vetëm do të shpallen me interes të përgjithshëm sepse atje për shkak se flitet se do të mbyllet ajo pika te fusha e futbollit dhe është paraparë një mbikalim i cili ka mundësi të kalon prapa objektit të doganës së Kosovës. Në pikën tre janë tri parcele të cilat janë paraparë për ndërtimin e shkollës në Lagje të Re. Në pikën katër i keni gjashtë parcele të cilët janë te Ura e Fezës sepse ekziston një variant për ndërtimin e mbikalimit.

Zaim Bela thekson:- sa kalime legale dhe ilegale janë në projektin e hekurudhës e cila po ndërtohet . Kalimi te Lagja Rana është ilegalë dhe pse mos me u përfshirë edhe Lagja Rana pasi është tu ndërtuar mbikalimi që ato banorë me dalë te Ura e Fezës . Mbikalimi te fusha e sportit kalojke vetëm te ata parcelat të cilat bien mbi hekurudhë dhe është mirë që në atë pjesë me u lidhë edhe fshati Seçishtë . Është mirë të shpallet me interes të përgjithshëm edhe rruga për shkak se fshati Paldenicë e ka vetëm një dalje për shkak se nuk di që ka ndonjë problem ajo rruga deri te Policia . Sa i përket parcelës për ndërtimin e shkollë a keni informacion se sa është paguar ajo pronë. Për këtë pikë të rendit të punës nuk do të votojë për.

Refet Kalisi thekson:- te parcelat te fusha e sportit e cila është pronë INA OKIT ju e dini që disa parcele janë kontestuese është mirë me i identifikuar pronarët . Pjesa poshtë e cila kërkohet me u shpronësuar që del te Vlasht a është për mbikalim për shkak të pikës që mbyllet te hekurudha është mirë që të na sqaroni. Mbikalimi që planifikohet te pronat te Ura e Fezës a do të jetë për vetura apo vetëm për këmbësorë . Pronën që planifikohet për ndërtim të shkollës unë mendoj se mundet me u bartë në emër të komunës dhe nëse nuk bëhen mjetet është mirë që me kompensuar me mjete të komunës.

Mehmet Ballazhi thekson:- secili ka të drejtë me votuar pro kundër ose abstenim por me arsyetimet që do të ipen besoj që do ta ndryshoni mënyrën e votimit . Fillimisht duhet të shpallen me interes të përgjithshëm për shkak se nëse nuk i shpallim me interes të përgjithshëm nuk mund të ndërmarrim asnjë hap tjetër për shkak se realizmi i projekteve varet prej buxhetit. Sot patëm takim me zëvendës ministrin e infrastrukturës dhe këto të cilat po i flasim janë me interes vital. Te Lagja Ranaj është vend kalim ilegal po ashtë edhe të “Bllaca 99” është vend kalim ilegal dhe kemi nevojë për këtë për shkak se ka qenë edhe kërkesë e qytetarëve. Sipas projekteve ideore janë dy ura të projektuara të cilat kushtojnë mbi një milion euro dhe nuk kemi buxhet për me i realizuar dhe pa pasur projekt nuk kemi të drejtë me parashtruar kërkesë në Ministrin përkatëse . Edhe

nëse komuna e ka të hartuar projektin por nëse nuk e ka të shpallur me interes publik nuk mund të realizohet projekti . Çështja e pronës për të shkolla iniciativa është e përkrahur edhe nga kryetari dhe është miratuar edhe në kuvend projekti për ndërtimin e shkollës . Ne jemi duke u mundur që qytetarët ta shpronësojmë për shkak të mungesës së mjeteve financiare në mënyrë që me ja kaluar komunës. Në momentin që qytetarët nuk munden me paguar të tërën do të mundohemi përmes komunës dhe për atë duhet të shpallet me interes të përgjithshëm.

Nexhmedin Daci thekson:- pronat private figurojnë në emër të INA OKIT dhe qytetarët nëse e fitojnë me gjykatë AKP-ja ua kryen pagesën. Çështjen e projektit të rrugës së Paldenicës në këtë vit nuk ka mundësi me u realizuar.

Ibadete Kalisi thekson:- nëse ndërtohet mbikalimi te Vlashtë çka do të bëhet me banorët.

Nexhmedin Daci thekson:-nuk ka asgjë konkrete për momenti por aty janë tri parcele të AKP-së por vetëm janë opsione dhe nuk ka vendim konkretë.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 10 për , 5 abstenim.

U MIRATUA PROPOZIM VENDIMI PËR SHPALLJEN ME INTERES TË PËRGJITHSHËM TË PARCELAVE KADASTRALE

9. Informatë për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2022.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mehmet Ballazhi thekson:-përveç materialit të cilin e kemi përcjell diçka të veçantë nuk kam.

Resul Suma thekson:- a është e vërtetë që më shumë se gjysma e kamerave të qytetit nuk janë funksionale dhe përgjegjësi e kujt është.

Mehmet Ballazhi thekson:- e kemi diskutuar edhe çështjen e kamerave dhe komuna ka planifikuar mjete financiare edhe për çështje të kamerave dhe e kemi diskutuar me policin për pikat që do të vendosen kamerat. Për çështje të kamerave kemi parashtruar kërkesë në Ministri të Punëve të Brendshme por nuk e kanë marr përsipër.

Natyra Kalisi thekson:- jemi në pritje të nënshkrimit të kontratës dhe kryetari ka vendosur me ndihmuar policin për shkak se ata kanë parashtruar kërkesë në komunë për këtë çështje.

Zaim Bela thekson:- policia e vijës së gjelbërt i kanë disa kamera mobile të cilat i vendosin kur kanë ndonjë rrezik diku. Është mirë me i vendos në vende të caktuara që janë me rrezikshmëri.

Mehmet Ballazhi thekson:- është vështirë që policia me i vendosë kamerat mobile për shkak se nuk kanë kapacitete. Ne kemi kërkuar që edhe te parku i qytetit polica me shkuar më shpesh.

Sherif Berisha thekson:-unë mendoj që policia e ka të drejtë për grup moshat e reja që në orë 23 apo 24 me i legjitimuar dhe me ju rekomanduar që me shkuar në shtëpi.

Mehmet Ballazhi thekson:- është cenim i të drejtës së lëvizjes së lirë të qytetarëve për shkak se ligji ua lejon. Sa për legjitimim sipërfaqësisht ndoshta munden me bërë por ne po mundohemi përmes kamerave dhe përmes edukimit përmes shkollave.

Refet Kalisi thekson:- a është shpallur tender për kamera të reja apo për mirëmbajtjen e kamerave të vjetra sepse janë kamerat dhe është mirë mos me investuar shumë por me i riparuar.

Natyra Kalisi thekson:- disa kamera janë jashtë funksionit por janë edhe disa kamera të cilat kanë me u rifunksionizuar për shkak se ju mungon programimi. Në disa pika që ka kërkuar policia do të vendosen kamera.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraprirë sipas agjendës.

10. Informatë për aktivitetet e këshillave të fshatrave të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2022.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Natyra Kalisi thekson:- në material i kemi paraqitur numrin e mbledhjeve të cilat janë mbajtur . Për vitin 2022 janë mbajtur gjashtë mbledhje . Këshillat e fshatrave janë duke u kompensuar prej komunës.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraprirë sipas agjendës.

11. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Resul Suma thekson:- kontrata e stomatologut dhe teknikës që paguhet prej kompanisë “Sharrcem” shënon prej muajit tetor deri në fund të muajit mars por ata kanë filluar në muajin dhjetorë apo në janar. A ka mundësi që ajo kontratë me u vazhduar për shkak se qytetarët janë shumë të kënaqur me atë shërbim dhe deri në muajin e kaluar afër 500 pacientë brenda këtyre muajve kanë kryer shërbime. Në QKMF janë të ndarë në dy pjesë dhe ka dallime edhe në shërbime dhe më vjen shumë keq për shkak se ata duhet ta kenë etikën e vetë si infermierë apo si mjekë në mënyrë që mos me dalluar pacientin . Ka ankesë nga qytetarët për pastrimin e plagëve të cilat bëhen vetëm para dite dhe nuk mund të ja caktojmë pacientit që mos me lënduar këmbën se nuk mundësh pasdite me kryer shërbim.

Mehmet Ballazhi thekson:- i kemi diskutuar këto çështje dhe nuk di që ka dallime ndoshta mund të ketë në aspektin moral të tyre dhe ne në shpirt nuk mundemi mi ndërhyjë askujt por nëse ka ndonjë ankesë që ka të bëjë me ndasinë atëherë merremi ne si institucion. Për çështjen e stomatologut jemi marr vesh me kompaninë Sharrcem që për një vit t'i vazhdohet stomatologut dhe infermieres . Sa i përket pastrimit të plagëve unë mendoj se të drejtë kanë që njëzet e katër orë por duhet ta kemi parasysh se është emergjencë ajo dhe nëse unë kam një plagë shkoj e pastroj paradite ndërsa në raste emergjente që ndodhë diçka kryhen shërbime. Ka raste që tërë ditën rrinë pastaj pas orës katër shkon me pastruar plagën që unë mendoj që nuk është emergjente.

Malik Berisha thekson:- pastrimi i plagëve bëhet nga ora shtatë e mëngjesit deri në ora 15:00 dhe nëse vjen dikush që e ka pastruar plagën brenda orari dhe vjen një ditë tjetër në urgjencë ne e krijojmë edhe një infeksion tjetër për shkak se janë sterile mjetet që punohet dhe nuk ka mundësi që në ora njëzet e dy me ardhur dhe me bërë pastrimin e rregullt të plagës për shkak se ja shkakton edhe një infeksion.

Sherif Berisha thekson:-kërkoj nga drejtoria për shëndetësi që të na njofton për bisedat të cilat i ka pasur me Islamik Relief për çështje e stafit. Gjatë kohës që motrat kanë qenë pushim te shërbimi i vaksinimit drejtori i arsimit e dërgojnë fëmijët e vetë dhe i vaksinonjë dhe mendoj që edhe qytetarët ta kesin atë të drejtë e jo vetëm drejtorët për shkak se pozitat nuk janë të përjetshme.

Kimete Kuka -Hasallari thekson:- sa i përket Islamik Reliefit kanë potencuar se nuk kanë interesim për me i mbështetur institucionet me staf sepse politikat e tyre kanë ndryshuar dhe mjetet financiare të cilat i kam ndarë për “Islamik Relief” i kam zhvilluar procedurat e prokurimit që të rekrutojmë staf me infermierë dhe një mjek. Te çështja e vaksinimit informata është e gabuar për shkak se e kemi pasur motrën me kontratë në vepër dhe e ka zëvendësuar motrën e cila jep vaksina që ka shkuar në pushim mjekësorë. Motra e cila jep vaksina ka shkuar në pushim pa paralajmërim dhe e kam ftuar që nuk guxon me nejtë sektori i vaksinimit për deri sa e kemi motrën në fjalë.

Sherif Berisha thekson:- nëse është shkuar në pushim pa miratim është mirë që të merrni masa dhe atë që e potencoj z. Resul Suma është e vërtetë që QKMF-ja është e ndarë në dy pjesë dhe është mirë me pasur një disiplinë duke filluar prej orarit të punës.

Hisni Luri thekson:-nuk ka diçka të keqe nëse nuk ka qenë një motër ka qenë një tjetër dhe nuk kam këmbëngulur por më është dashur me vaksinuar atë ditë për shkak se të nesërmen ishte ditë pushimi dhe unë kam pasur agjendë për me shkuar në trajnim. Ju e dini që njëzet e katër orë pas vaksinimit duhet të jem në mënyrë që me qenë afër sepse ka mundësi me pasur temperaturë e mos me mbetur pa përkujdesje prindërore.

Hanumshahe Dibrani thekson:- te rruga Lepenci që është rregulluar parku a do të hiqet dhoma e pritjes e cila është.

Mehmet Ballazhi thekson:- për momentin nuk priset dhe do të shikohem mundësit në të ardhmen.

Refet Kalisi thekson:- te rruga te lagja Ballazhi në Puset e Nikës kishte nevojë për mure shumë dhe nëse ka nevojë për me u shtuar buxhet është mirë me shtuar në mënyrë që të bëhet mirë. Te parku “Isa Berisha “ janë bërë shumë dëme dhe është mirë në të ardhmen me pasur një mirëmbajtës.

Mehmet Ballazhi thekson:- jemi duke u mundur që çdo projekt që bëhet me u bërë konformë standardeve që kërkohet dhe për shkak të mungesës së mjeteve financiare që ka ndodhur me ngritjen e çmimeve të materialeve është bërë në disa pjesë dhe muret mundemi mi rregulluar edhe më vonë.

Erblin Meliqi thekson:- të bëhet vendosja e pasqyrave rrugore në Lagjen Meliq. Shtimi i ndriçimit publik te rruga Veteranët e Luftës.

Arsim Dernjani thekson:- për pasqyra për momentin nuk kemi ndonjë plan për shkak të mjeteve , ndërsa për çështje të ndriçimit publik do të mundohemi me kryer.

Malik Berisha thekson:- sa infermierë dhe sa mjekë do të pranohen. Sa i përket vaksinimit në Han të Elezit është 95 % , ndërsa në nivel të Kosovës 94 % qo do të thotë që kjo vlerësohet.

Kimete Kuka -Hasallari thekson:- kemi zhvilluar procedurat përmes prokurimit dhe varet se cila organizatë konkuronë.

Sherif Berisha thekson:- pse nuk është pranuar në çerdhe fëmija i z.Kushtrim Loku.

Hisni Luri thekson:- në çerdhe është një rregullore për pranimin e fëmijëve dhe përmes asaj shpallet konkursi dhe nuk e di arsyen për këtë rast dhe nëse është plotësuar numri nuk ka pasur hapësirë më shumë ndoshta po sido qoftë do të interesohem për këtë çështje.


Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen.

Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 12:56.

Procesmbajtësi

Avni Bushi



Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA - MUNICIPALITY
HANI I ELEZIT



Nr. 04 / ³⁰⁸⁷ /2023

DATA :	07.04.2023
PËR :	KPF dhe Kuvendin Komunal
PËRMES :	Mehmet Ballazhi Kryetar i Komunës së Hanit të Elezit
NGA :	Lindita Ballazhi Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa
LËNDA :	Raporti financiar për periudhën janar-mars 2023

Të nderuar,

Bazuar në ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të dispozitave të nenit 45, paragrafët 45.2 dhe 45.4, si dhe statutit të komunës së Hanit të Elezit të nenit 51, paragrafi 5, gjeni të bashkangjitur raportin financiar për periudhën janar-mars 2023.

Me respekt,



Republika e Kosovës - Republic of Kosova
Komuna – Municipality
Hani i Elezit



Nr. 04/3087
Data: 07.04.2023

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

RAPORT FINANCIAR PËR PERIUDHËN JANAR-MARS 2023

Hani i Elezit, Prill 2023

1. Hyrje

Raporti financiar për periudhën janar - mars 2023, është përgatitur në bazë të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të dispozitave të nenit 45, paragrafët 45.2 dhe 45.4, si dhe Statutin e Komunës së Hanit të Elezit të nenit 51, paragrafi 5.

Ky raport përmban një përmbledhje të trendeve kryesore të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore përgjatë periudhës tremujore të vitit 2023. Raporti përmban analiza përmbledhëse të periudhës përkatëse, pasqyron të hyrat sipas drejtorive, sipas llojit të të hyrave si dhe krahasimet me periudhat paraprake dhe projeksionet buxhetore.

1.1 Performanca e të hyrave

Të hyrat vetanake: gjatë tremujorit të parë të vitit 2023 kemi realizuar të hyra në shumë prej 43,749.54 € dhe paraqesin 7.8 % të të hyrave të përgjithshme të planifikuara vjetore, ndërsa krahasuar me realizimin e tremujorit të vitit paraprak në vlerë prej 65,244.90 € kemi një rënie për 21,495.36 €.

1.2 Performanca e shpenzimeve

Shpenzimet buxhetore: gjatë tremujorit të parë të vitit 2023 pagesat ishin në shumë prej 521,326.93 € dhe paraqesin 15.56 % të shpenzimeve të përgjithshme të planifikuara, ndërsa krahasuar me realizimin e tremujorit të vitit paraprak 2022 kemi një rritje të shpenzimeve prej 107,565.68 € apo 26% më shumë shpenzime.

- **Shpenzimet për paga dhe shtesa** shënuan vlerën prej 438,190.62 € gjatë këtij tremujori, duke arritur kështu normën e ekzekutimit në 25.73% krahasuar me vlerën totale të buxhetuar për këtë kategori. Shpenzimet për paga dhe shtesa gjatë periudhës raportuese paraqesin një rritje prej 17.24 % apo për 64,439.55 € më shumë krahasuar me shpenzimet e pagave dhe shtesave për periudhën e njëjtë të vitit 2022.
- **Shpenzimet për mallra dhe shërbime** shënuan vlerën prej 56,767.57 € gjatë këtij tremujori, duke arritur kështu normën e ekzekutimit 12.31%, krahasuar me vlerën totale vjetore të buxhetuar për këtë kategori. Gjatë kësaj periudhe raportuese kemi një rritje në shpenzime për mallra dhe shërbime në krahasim me vitin paraprak me diferencë në shpenzim prej 28,728.11 €.
- **Shërbimet komunale** shënuan vlerën prej 20,428.74 € duke arritur kështu normën e ekzekutimit 21.17% krahasuar me vlerën totale vjetore të buxhetuar për këtë kategori. Gjatë kësaj periudhe raportuese kemi një rritje të shpenzimeve për shërbime komunale në krahasim me vitin paraprak në vlerë prej 8,458.02 €.

- **Shpenzimet për subvencione dhe transfere** – gjatë tre mujorit të parë të vitit 2023 kemi pasur shpenzime të kësaj kategorie në vlerë prej 3,400 € ose 3.40% nga planifikimi i të njejtës kategori, ndërsa përgjatë TM1 në vitin 2022 nuk kemi pasur shpenzime në këtë kategori.
- **Shpenzimet kapitale** – Gjatë TM1 të vitit aktual shpenzimi për këtë kategori është në vlerë prej 2,540 € ose 0.26 % nga shpenzimet e planifikuara për këtë kategori Vitin e kaluar 2022, gjatë periudhës së njejtë raportuese nuk kemi pasur shpenzime.

2. BUXHETI KOMUNAL 2023

Buxheti i komunës së Hanit të Elezit i ndarë sipas Ligjit me nr. 08/L-193 mbi ndarjet buxhetore të Republikës së Kosovës për vitin 2023 është në lartësi prej **3,349,715 Euro**.

Ky buxhet është ndarë sipas kategorive ekonomike si në vijim:

- Paga dhe shtesa..... 1,702,823.00 €,
- Mallra dhe shërbime..... 465,000.00 €,
- Shërbime komunale..... 96,500.00 €,
- Subvencione dhe transfere... 100,000.00 €,
- Shpenzime kapitale..... 985,392.00 €,

Totali i buxhetit..... 3,349,715.00 €.

Nisur nga vlerësimi i përgjithshëm del se niveli i shpenzimit të buxhetit për këtë periudhë janar-mars 2023 është në shumë prej 521,326.93 € apo 15.56 %.

Prej tyre shpenzimi sipas kategorive është si vijon:

- Paga dhe shtesa në shumë prej 438,190.62 € apo 25.73 %,
- Mallra dhe shërbime në shumë prej 56,767.57 € apo 12.21 %,
- Shërbime komunale në shumë prej 20,428.74 € apo 21.17 %,
- Subvencione dhe transfere në shumë prej 3,400.00 € apo 3.40 % dhe
- Shpenzime kapitale në shumë prej 2,540.00 € apo 0.26%.

3. KRAHASIMI I PAGESAVE PËR PERIUDHËN JANAR-MARS 2023/2022

Kategoritë ekonomike të shpenzimeve	Buxheti 2023	Realizimi janar-mars 2023	%	Buxheti 2022	Realizimi janar-mars 2022	%	Krahasimi në euro 2023/22	Krahasimi në % 2023/22
Paga dhe shtesa	1,702,823.00	438,190.62	25.73%	1,756,083.00	373,751.07	21.28%	64,439.55	17.24%
Mallra dhe shërbime	465,000.00	56,767.57	12.21%	385,975.00	28,039.46	7.26%	28,728.11	102.46%
Shpenzime komunale	96,500.00	20,428.74	21.17%	67,700.00	11,970.72	17.68%	8,458.02	70.66%
Subvencione dhe trans.	100,000.00	3,400.00	3.40%	80,000.00	0	0.00%	3,400.00	0.00%
Shpenzime kapitale	985,392.00	2,540.00	0.26%	455,000.00	0	0.00%	2,540.00	0.00%
Rezervat	0.00	0.00	0.00%	15,000.00	0	0.00%	0.00	0.00%
TOTAL	3,349,715.00	521,326.93	15.56%	2,759,758.00	413,761.25	14.99%	107,565.68	26.00%

Komente dhe shpjegime:

- Pagesat nga kategoria ekonomike **paga dhe shtesa** janë shpenzuar në shumë prej 438,190.62 € ose 25.73% të planit vjetor, ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022 pagesat për këtë kategori kanë shënuar rritje për 64,439.55 €.
- Pagesat për këtë kategori ekonomike **mallra dhe shërbime** për tre mujorin e parë 2023 janë 56,767.57 € apo 12.21% e planit vjetor, ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022 kemi rritje prej 28,728.11 €.
- Pagesat për **shërbime komunale** për tremujorin e parë 2023 janë në shumë prej 20,428.74 € apo 21.17% e planit vjetor, ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022 kemi një rritje prej 8,458.02 €.
- Pagesat nga kategoria **subvencione dhe transfere** gjatë tre mujorit të parë të vitit 2023 kemi pasur shpenzime të kësaj kategorie në vlerë prej 3,400 € ose 3.40% nga planifikimi i të njëjtës kategori, ndërsa përgjatë TM1 në vitin 2022 nuk kemi pasur shpenzime në këtë kategori.
- **Shpenzimet kapitale** gjatë TM1 të vitit aktual për këtë kategori janë në vlerë prej 2,540 € ose 0.26 % nga shpenzimet e planifikuara për këtë kategori. Vitin e kaluar 2022, gjatë periudhës së njëjtë raportuese nuk kemi pasur shpenzime.

Gjithsej shpenzimet për periudhën janar-mars 2023, për të gjitha kategoritë ekonomike të shpenzimeve janë në shumë prej 521,326.93 € apo 15.56% e planit të përgjithshëm vjetor, ndërsa

në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak kemi një rritje prej 107,565.68 € apo 26 % më shumë shpenzime.

4. BUXHETI I KOMUNËS SIPAS DREJTORIVE DHE KATEGORIVE EKONOMIKE

Përshkrimi	Buxheti Aktual	Allocated	E paalokuar	Aktuali	Zotim /Obligimet në pritje	Buxheti FreeBalance	Progresi në %
CAT / RESP / PCLASS / SUBCL	A	B	A - B	C	D	A - (C + D)	A - E
10 BUXHETI	2,791,483.65	1,525,517.40	1,265,966.25	516,941.14	21,889.41	2,252,653.10	18.52
659 HANI I ELEZIT	2,791,483.65	1,525,517.40	1,265,966.25	516,941.14	21,889.41	2,252,653.10	18.52
16035 ZYRA E KRYETARIT - HANI I ELEZIT	103,011.99	46,630.21	56,381.78	25,791.26	913.65	76,307.08	25.04
11 PAGA DHE SHITESA	78,011.99	21,630.21	56,381.78	21,630.21	0.00	56,381.78	27.73
13 MALLRA DHE SHËRBIME	25,000.00	25,000.00	0.00	4,161.05	913.65	19,925.30	16.64
16335 ADMINISTRATA - HANI I ELEZIT	218,130.00	148,406.67	69,723.33	48,455.10	8,514.07	161,160.83	22.21
11 PAGA DHE SHITESA	93,130.00	23,406.67	69,723.33	23,346.32	0.00	69,783.68	25.07
13 MALLRA DHE SHËRBIME	65,000.00	65,000.00	0.00	8,872.74	8,280.57	47,846.69	13.65
14 SHPENZIME KOMUNALE	60,000.00	60,000.00	0.00	16,236.04	233.50	43,530.46	27.06
16935 ZYRA E KUVENDIT KOMUNAL - HANI I ELEZIT	76,719.00	45,231.47	31,487.53	31,128.11	0.00	45,590.89	40.57
11 PAGA DHE SHITESA	61,719.00	30,231.47	31,487.53	30,231.47	0.00	31,487.53	48.98
13 MALLRA DHE SHËRBIME	15,000.00	15,000.00	0.00	896.64	0.00	14,103.36	5.98
17535 BUXHETI - HANI ELEZIT	59,600.99	18,102.76	41,498.23	14,384.69	770.00	44,446.30	24.13
11 PAGA DHE SHITESA	54,600.99	13,102.76	41,498.23	12,672.24	0.00	41,928.75	23.21
13 MALLRA DHE SHËRBIME	5,000.00	5,000.00	0.00	1,712.45	770.00	2,517.55	34.25
18444 PARANDALIMI DHE INSPEKTIMI I ZJARRIT	176,389.00	126,531.80	49,857.20	29,620.83	901.00	145,867.17	16.79
11 PAGA DHE SHITESA	66,389.00	16,531.80	49,857.20	16,531.80	0.00	49,857.20	24.90
13 MALLRA DHE SHËRBIME	60,000.00	60,000.00	0.00	13,089.03	901.00	46,009.97	21.82
30 PASURITË JOFINANCIARE	50,000.00	50,000.00	0.00	0.00	0.00	50,000.00	0.00
19675 ZYRA LOKALE E KOMUNITETEVE - HANI I ELEZIT	6,826.99	2,232.08	4,594.91	1,667.17	0.00	5,159.82	24.42
11 PAGA DHE SHITESA	6,326.99	1,732.08	4,594.91	1,667.17	0.00	4,659.82	26.35
13 MALLRA DHE SHËRBIME	500.00	500.00	0.00	0.00	0.00	500.00	0.00
47115 PYLLTARIA INSPEKSIONI - HANI I ELEZIT	32,438.00	11,163.32	21,274.68	7,708.32	0.00	24,729.68	23.76
11 PAGA DHE SHITESA	28,938.00	7,663.32	21,274.68	7,663.32	0.00	21,274.68	26.48
13 MALLRA DHE SHËRBIME	3,500.00	3,500.00	0.00	45.00	0.00	3,455.00	1.29
48035 PLANIFIKIMI DHE ZHVILLIMI EKONOMIK - HANI ELEZIT	24,544.00	9,035.42	15,508.58	8,051.42	0.00	16,492.58	32.80
11 PAGA DHE SHITESA	21,544.00	6,035.42	15,508.58	6,035.42	0.00	15,508.58	28.01
13 MALLRA DHE SHËRBIME	3,000.00	3,000.00	0.00	2,016.00	0.00	984.00	67.20
66480 PLANIFIKIMI URBANIZMI INSPEKSIONI - HANI ELEZIT	439,706.99	399,032.90	40,674.09	19,818.18	6,899.75	412,989.06	4.51

11 PAGA DHE SHITESA	56,276.99	15,602.90	40,674.09	15,602.90	0.00	40,674.09	27.73
13 MALLRA DHE SHËRBIME	14,959.00	14,959.00	0.00	1,675.28	0.00	13,283.72	11.20
30 PASURITË JOFINANCIARE	368,471.00	368,471.00	0.00	2,540.00	6,899.75	359,031.25	0.69
73044 ADMINISTRATA - HANI I ELEZIT	16,584.00	5,205.02	11,378.98	4,705.02	0.00	11,878.98	28.37
11 PAGA DHE SHITESA	16,084.00	4,705.02	11,378.98	4,705.02	0.00	11,378.98	29.25
13 MALLRA DHE SHËRBIME	500.00	500.00	0.00	0.00	0.00	500.00	0.00
75050 SHËRBIMET E KUJDESIT PRIMAR SHËNDETËSOR - HANI I ELEZIT	366,451.05	176,719.40	189,731.65	74,431.97	2,267.40	289,751.68	20.31
11 PAGA DHE SHITESA	251,951.05	62,219.40	189,731.65	62,219.40	0.00	189,731.65	24.70
13 MALLRA DHE SHËRBIME	70,000.00	70,000.00	0.00	10,212.57	2,240.97	57,546.46	14.59
14 SHPENZIME KOMUNALE	14,500.00	14,500.00	0.00	2,000.00	26.43	12,473.57	13.79
30 PASURITË JOFINANCIARE	30,000.00	30,000.00	0.00	0.00	0.00	30,000.00	0.00
75671 SHËRBIMET SOCIALE - HANI I ELEZIT	23,527.99	8,714.65	14,813.34	5,032.07	0.00	18,495.92	21.39
11 PAGA DHE SHITESA	19,727.99	4,914.65	14,813.34	4,914.65	0.00	14,813.34	24.91
13 MALLRA DHE SHËRBIME	2,800.00	2,800.00	0.00	87.42	0.00	2,712.58	3.12
14 SHPENZIME KOMUNALE	1,000.00	1,000.00	0.00	30.00	0.00	970.00	3.00
92175 ADMINISTRATA - HANI I ELEZIT	99,900.67	76,111.47	23,789.20	18,848.91	384.00	80,667.76	18.87
11 PAGA DHE SHITESA	32,900.67	9,111.47	23,789.20	9,111.47	0.00	23,789.20	27.69
13 MALLRA DHE SHËRBIME	52,000.00	52,000.00	0.00	9,737.44	384.00	41,878.56	18.73
30 PASURITË JOFINANCIARE	15,000.00	15,000.00	0.00	0.00	0.00	15,000.00	0.00
92890 ARSIMI PARAFILLOR DHE ÇERDHET - HANI I ELEZIT	76,582.99	30,129.61	46,453.38	19,358.50	62.20	57,162.29	25.28
11 PAGA DHE SHITESA	63,332.99	16,879.61	46,453.38	16,879.61	0.00	46,453.38	26.65
13 MALLRA DHE SHËRBIME	10,250.00	10,250.00	0.00	1,946.88	62.20	8,240.92	18.99
14 SHPENZIME KOMUNALE	3,000.00	3,000.00	0.00	532.01	0.00	2,467.99	17.73
94020 ARSIMI FILLOR - HANI I ELEZIT	901,612.00	376,176.20	525,435.80	172,331.47	1,177.34	728,103.19	19.11
11 PAGA DHE SHITESA	695,699.00	170,263.20	525,435.80	170,263.20	0.00	525,435.80	24.47
13 MALLRA DHE SHËRBIME	78,413.00	78,413.00	0.00	1,031.28	1,177.34	76,204.38	1.32
14 SHPENZIME KOMUNALE	14,500.00	14,500.00	0.00	1,036.99	0.00	13,463.01	7.15
30 PASURITË JOFINANCIARE	113,000.00	113,000.00	0.00	0.00	0.00	113,000.00	0.00
95220 ARSIMI I MESËM - HANI I ELEZIT	169,457.99	46,094.42	123,363.57	35,608.12	0.00	133,849.87	21.01
11 PAGA DHE SHITESA	158,079.99	34,716.42	123,363.57	34,716.42	0.00	123,363.57	21.96
13 MALLRA DHE SHËRBIME	7,878.00	7,878.00	0.00	298.00	0.00	7,580.00	3.78
14 SHPENZIME KOMUNALE	3,500.00	3,500.00	0.00	593.70	0.00	2,906.30	16.96
21 TE HYRAT VETANAKE	560,121.00	9,992.16	550,128.84	4,385.79	15.00	555,720.21	0.78
659 HANI I ELEZIT	560,121.00	9,992.16	550,128.84	4,385.79	15.00	555,720.21	0.78
16035 ZYRA E KRYETARIT - HANI I ELEZIT	47,500.00	4,000.00	43,500.00	3,400.00	0.00	44,100.00	7.16
20 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	47,500.00	4,000.00	43,500.00	3,400.00	0.00	44,100.00	7.16
16335 ADMINISTRATA - HANI I ELEZIT	15,000.00	0.00	15,000.00	0.00	0.00	15,000.00	0.00
13 MALLRA DHE SHËRBIME	15,000.00	0.00	15,000.00	0.00	0.00	15,000.00	0.00
18444 PARANDALIMI DHE INSPEKTIMI I ZJARRIT	35,000.00	0.00	35,000.00	0.00	0.00	35,000.00	0.00

13 MALLRA DHE SHËRBIME	15,000.00	0.00	15,000.00	0.00	0.00	15,000.00	0.00
20 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	15,000.00	0.00	15,000.00	0.00	0.00	15,000.00	0.00
30 PASURITË JOFINANCIARE	5,000.00	0.00	5,000.00	0.00	0.00	5,000.00	0.00
47115 PYLLTARIA INSPEKSIONI - HANI I ELEZIT	11,500.00	0.00	11,500.00	0.00	0.00	11,500.00	0.00
20 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	11,500.00	0.00	11,500.00	0.00	0.00	11,500.00	0.00
66480 PLANIFIKIMI URBANIZMI INSPEKSIONI - HANI I ELEZIT	327,530.00	0.00	327,530.00	0.00	0.00	327,530.00	0.00
13 MALLRA DHE SHËRBIME	6,000.00	0.00	6,000.00	0.00	0.00	6,000.00	0.00
30 PASURITË JOFINANCIARE	321,530.00	0.00	321,530.00	0.00	0.00	321,530.00	0.00
75050 SHËRBIMET E KUJDESIT PRIMAR SHËNDETËSOR - HANI I ELEZIT	6,460.00	0.00	6,460.00	0.00	0.00	6,460.00	0.00
13 MALLRA DHE SHËRBIME	6,460.00	0.00	6,460.00	0.00	0.00	6,460.00	0.00
75671 SHËRBIMET SOCIALE - HANI I ELEZIT	200.00	0.00	200.00	0.00	0.00	200.00	0.00
13 MALLRA DHE SHËRBIME	200.00	0.00	200.00	0.00	0.00	200.00	0.00
92175 ADMINISTRATA - HANI I ELEZIT	31,000.00	4,922.16	26,077.84	0.00	0.00	31,000.00	0.00
20 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	26,000.00	4,922.16	21,077.84	0.00	0.00	26,000.00	0.00
30 PASURITË JOFINANCIARE	5,000.00	0.00	5,000.00	0.00	0.00	5,000.00	0.00
92890 ARSIMI PARAFILLOR DHE ÇERDHET - HANI I ELEZIT	8,540.00	1,070.00	7,470.00	985.79	15.00	7,539.21	11.54
13 MALLRA DHE SHËRBIME	8,540.00	1,070.00	7,470.00	985.79	15.00	7,539.21	11.54
94020 ARSIMI FILLOR - HANI I ELEZIT	77,391.00	0.00	77,391.00	0.00	0.00	77,391.00	0.00
30 PASURITË JOFINANCIARE	77,391.00	0.00	77,391.00	0.00	0.00	77,391.00	0.00
Totali i Përgjithshëm	3,351,604.65	1,535,509.56	1,816,095.09	521,326.93	21,904.41	2,808,373.31	15.55

4.1 PAGAT DHE MËDITJET

Kodi	Përshkrimi	Shpenzimi janar-mars 2023	Shpenzimi janar-mars 2022	Krahasimi 2023-2022	Krahasimi në %
1	Paga dhe shtesa				
11110	Pagat neto permes listes se pagave	371,641.86	317,748.09	53,893.77	16.96
11115	Pagesa për sindikatë	767.06	1,187.03	(419.97)	(35.38)
11125	Anëtarësim-Oda e Infermierëve të Kosovës	141.07	139.04	2.03	1.46
11126	Anëtarësim-Oda e Mjekëve të Kosovës	480.00	480	-	-
11400	Punëtorët me kontratë-jo ne listen e pagave	-	0.00	-	-
11500	Tatimi i ndalur në të ardhurat personale	23,841.69	18,688.89	5,152.80	27.57
11600	Kontributi pensional-punëtori	20,659.47	17,754.01	2,905.46	16.37
11700	Kontributi pensional-punëdhësi	20,659.47	17,754.01	2,905.46	16.37
11900	Pagesa për vendime gjyqësore	-	-	-	-
	Totali për paga dhe shtesa	438,190.62	373,751.07	64,439.55	17.24

4.2 PËRMBLEDHJE E MALLRAVE DHE SHËRBIMEVE

2	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimi janar - mars 2023	Shpenzimi janar - mars 2022	Krahasimi 2023- 2022	Krahasimi në %
13130	Shpenzimet e udhëtimit zyrtar brenda vendit (transporti i nxënësve)	5,969.44	6,157.50	-188.06	-3.05
13140	Shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit		-	0.00	0.00
13310	Shpenzimet për internet	760.00	-	760.00	0.00
13320	Shpenzimet e telefonisë mobile	1,020.50	2,218.94	-1,198.44	-54.01
13330	Shpenzimet postare		-	0.00	0.00
13141	Shpenzime të vogla - Para xhepi	156.00	-	156.00	0.00
13142	Akomodimi-Udhëtimet zyrtare jashtë vendit		-	0.00	0.00
13143	Shpenzimet tjera të udhëtimeve zyrtare jashtë vendit		-	0.00	0.00
13420	Shërbimet e përfaqësimit-avokaturës		-	0.00	0.00
13430	Shërbime të ndryshme shëndetësore		30.00	-30.00	-100.00
13440	Shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshilldhënëse	1,018.00	-	1,018.00	0.00
13450	Shërbimet e shtypit - Jo marketing		-	0.00	0.00
13460	Shërbime kontraktuese tjera	10,960.76	1,140.00	9,820.76	861.47
13470	Shërbime teknike		-	0.00	0.00
13480	Shpenzimet për anëtarim	2,910.45	-	2,910.45	0.00
13490	Shërbime e varrimit		-	0.00	0.00
13501	Mobilje me pak se 1000 euro		-	0.00	0.00
13502	Telefona (më pak se 1000 euro)	999.50	-	999.50	0.00
13503	Kompjuter me pak se 1000 euro	-	-	0.00	0.00
13506	Paisje specialistike mjekësore më pak se 1000€	-	-	0.00	0.00
13509	Pajisje tjera me pak se 1000 euro	450.00	-	450.00	0.00
13510	Blerja e librave dhe veprave artistike	-	-	0.00	0.00
13610	Furnizim për zyrë	952.00	607.84	344.16	56.62
13620	Furnizim me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare)	5,029.96	850.00	4,179.96	491.76
13630	Furnizime mjekësore	330.00	-	330.00	0.00
13640	Furnizime pastrimi	420.55	667.50	-246.95	-37.00
13650	Furnizim me veshmbathje	-	-	0.00	0.00
13660	Akomodim	-	-	0.00	0.00
13760	Dru	-	-	0.00	0.00
13770	Derivate për gjenerator	181.90	-	181.90	0.00
13780	Karburant për vetura	5,131.70	-	5,131.70	0.00
13810	Avans për pety cash	1,000.00	1,000.00	0.00	0.00
13917	Provizioni Bankar	-	-	0.00	0.00
13950	Regjistrimi i automjeteve	375.00	385.00	-10.00	-2.60
13951	Sigurimi i automjeteve	1,271.37	1,117.68	153.69	13.75
14010	Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	328.00	520.00	-192.00	-36.92
14020	Mirëmbajtja e ndërtesave	700.00	-	700.00	0.00

14023	Mirëmbajtja e shkollave	3,639.10	3,200.00	439.10	13.72
14024	Mirëmbajtja e objekteve shëndetësore	1,104.00	-	1,104.00	
14032	Mirëmbajtja e rrugëve lokale	7,730.80	9,728.00	-1,997.20	-20.53
14050	Mirëmbajtja e mobileve dhe paisjeve	-	-	0.00	0.00
14130	Qiraja për paisje	701.34		701.34	0.00
14140	Qiraja për makinë	988.00	-	988.00	0.00
14210	Reklamata dhe konkurset	-	-	0.00	0.00
14220	Botimet e publikimeve	-	192.00	-192.00	-100.00
14310	Drekat zyrtare	1,855.20	225.00	1,630.20	724.53
14410	Shpenzime-vendimet e gjykatave	784.00	-	784.00	#DIV/0!
	Totali për mallra dhe shërbime	56,767.57	28,039.46	28,728.11	102.46

4.3 SHËRBIMET KOMUNALE

3	Shpenzimet komunale	Shpenzimi 2023	Shpenzimi 2022	Krahasimi 2023-2022	Krahasimi në %
13210	Rryma	17,776.31	10,301.92	7,474.39	72.55
13230	Mbeturinat	2,410.00	1,450.00	960.00	66.21
13250	Shpenzimet e telefonisë fikse	242.43	218.80	23.63	10.80
	Totali për shpenzime komunale	20,428.74	11,970.72	8,458.02	70.66

4.4 SUBVENCIONET DHE TRANSFERET

4	Subvencionet dhe transferet	Shpenzimi 2023	Shpenzimi 2022	Krahasimi 2023-2022	Krahasimi në %
21200	Subvencione për entitete jo-publike	-	-	0.00	0.00
22100	Transfere për qeveri tjera	-	-	0.00	0.00
22200	Pagesë për përfitues individual	3,400.00	-	3,400.00	0.00
	Totali në subvencione dhe transfere	3,400.00	-	3,400.00	0.00

4.5 SHPENZIMET KAPITALE JANAR-MARS 2023

Nr	Kodi	Programi/përshkrimi	10-BKK	21-THV	TOTALI 2023	Shpenzimi Janar-Mars 2023
		SHPENZIMET KAPITALE TOTALE	576,471	408,921	985,392	2,540
	180	Shërbimet publike dhe emergjenca	50,000	5,000	55,000	-
	18444	Parandalimi dhe inspektimi i zjarreve	50,000	5,000	55,000	-
1	51616	Rregullimi i kanalit të ujitjes në vendin Lloka në Seçishtë	5,000	-	5,000	0
2	53735	Ndërtimi i pendës në Sarasellë në fshatin Seçishtë	5,000	-	5,000	0
3	53750	Rregullimi i krojeve publike në fshatrat: Dromjak, Dimcë, Paldenicë dhe Rezhancë	5,000	-	5,000	0
4	53772	Ndriçimi publik në fshatrat: Pustenik, Dimcë, Gorancë, Krivenik, Seçishtë	15,000	-	15,000	0
5	53773	Shtimi i kapaciteteve të ujit dhe vendosja e ujëmatësve në Lagjen e Re dhe në Han të Elezit	20,000	5,000	25,000	0
	660	Planifikim urban dhe mjedisi	368,471	321,530	690,001	2,540
	66480	Planifikimi urban dhe inspeksioni	368,471	321,530	690,001	2,540
6	41635	Rregullimi i shtratit të lumit Lepenc	5,000	-	5,000	0
7	41641	Mjete të lira për bashkëinvestime	35,000	5,000	40,000	0
8	47270	Asfaltimi i rrugës Gorancë-Krivenik	18,375	114,530	132,905	0
9	51071	Rregullimi i varrezave të qytetit	8,000	12,000	20,000	0
10	51085	Rregullimi i parkut në rrugën "Isa Berisha" (asfaltim, trotuar, ndriçim publik, gjelbërim)	15,000	5,000	20,000	0
11	51581	Rregullimi i kanalizimeve në Han të Elezit në Rr. Isa Berisha dhe zonat rurale në fshatrat: Paldenicë, Seçishtë, Pustenik, Gorancë, Dermjak, Krivenik, Dimcë	30,000	30,000	60,000	0
12	51589	Rregullimi i prockave dhe i kanalizimeve atmosferike në zonën urbane Rr. Adem Jashari dhe fshatin Paldenicë	30,000	10,000	40,000	0
13	51604	Ndërtimi i rrugës transit në fshatin Gorancë	-	-	-	0
14	51721	Vendosja e pajisjes digjitale E-Kioska në Han të Elezit	-	-	-	0
15	51722	Ndërtimi dhe rregullimi i këndeve të lojërave në Han të Elezit dhe fshatrat Gorancë, Paldenicë, Seçishtë	15,000	5,000	20,000	0

16	52894	Ndërtimi i mureve mbrojtëse në Lagjen e Re dhe në fshatrat: Paldenicë, Dermjak, Pustënik, Seçishtë, Gorancë, Krivenik, Dimcë	40,000	25,000	65,000	0
17	52906	Vendosja e ekranit për prezantimin e rezultateve të ndotjes së ajrit në Rr. Nuri Bushi	5,000	-	5,000	0
18	53121	Renovimi i objektit të Komunës	30,000	30,000	60,000	0
19	53201	Asfaltimi i rrugës Lagja Ramuk - Fshati Paldenicë	-	5,000	5,000	0
20	53366	Ndërtimi i parkut të rruga Lepenci	20,000	15,000	35,000	0
21	53370	Ndërtimi i trotuareve për këmbësor në Han të Elezit në Rr. Adem Jashari, Udhë e Shkronjave, Driton Loku, Paldenicë	10,000	5,000	15,000	0
22	53429	Ndërtimi i mbikalimeve në Rr. Martirët Bushi dhe Rr. Lepenci	2,096	5,000	7,096	0
23	53435	Ndërtimi i aneksit për këmbësor në urën e Seçishtës	10,000	-	10,000	0
24	53471	Shtirimi me kubëza betoni të rrugicave dhe trotuareve në Han të Elezit dhe fshatrat: Paldenicë, Seçishtë, Dimcë, Pustënik, Gorancë, Dermjak, Rezhancë, Krivenik	30,000	20,000	50,000	0
25	53484	Ndërtimi (Rihapja, zgjerimi) dhe asfaltimi i rrugëve në fshatrat: Paldenicë, Pustënik, Seçishtë, Gorancë, Dimcë, Krivenik	40,000	20,000	60,000	0
26	53902	Fabrika e ujit nga ujësjellesi i Dimcës, Shtëpia e Kulturës - Imri Curri, Stadiumi i qytetit - Suad Brava - Shpronësim	10,000	5,000	15,000	2,540
27	51363	Rregullimi i shtigjeve për këmbësor dhe çiklistë përgjatë lumit Lepenc (Uji i thartë - Kulla me çeshmë)	15,000	10,000	25,000	0
	730	Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale	30,000	-	30,000	-
	75050	Shërbimet e shëndetësisë primare	30,000	-	30,000	-
28	52815	Rregullimi i oborrit të AMF-së në fshatin Gorancë	5,000	-	5,000	0
29	53030	Rregullimi i infrastrukturës dhe ndërtimi i një aneks objekti në QKMF	25,000	-	25,000	0
	920	Arsimi dhe shkenca	128,000	82,391	210,391	-
	92175	Administrata	15,000	5,000	20,000	

30	51724	Ndërtimi i shkallëve emergjente nëpër shkollat: SHML. Dardania, SHFMU. Veli Ballazhi, SHFMU. Kështjella e Diturisë	15,000	5,000	20,000	0
	94020	Arsimi fillor, i mesëm i ulët	113,000	77,391	190,391	-
31	52945	Ndërtimi i objektit të SHFMU në Lagjen e Re	58,000	65,391	123,391	
32	53774	Rregullimi i infrastrukturës shkollore në SHML - Dardania, SHFMU - Ilaz Thaçi, SHFMU - Kështjella e Diturisë dhe SHMFU - Veli Ballazhi	55,000	12,000	67,000	0

5. RAPORT I TË HYRAVE VETANAKE PËR PERIUDHËN JANAR-MARS 2023

Nr	Përshkrimi	Realizimi 2023	Realizimi 2022	Krahasimi në euro 2023-2022
		2	3	5=2-3
1	Certifikatat e lindjes	1.00	80.00	(79.00)
2	Certifikatat e kurorëzimit	150.00	130.00	20.00
3	Certifikatat e vdekjes	2.00	20.00	(18.00)
4	Certifikata tjera ofiqarie	1,397.00	1,061.00	336.00
5	Taksa për verifikimin e dok. të ndryshme	8.00	7.00	1.00
6	Taksa administrative	49.00	25.00	24.00
I	Administrata e Përgjithshme	1,607.00	1,323.00	284.00
7	Tatimi në pronë dhe në tokë	23,537.06	34,974.44	(11,437.38)
8	Taksë për regjistrim të automjeteve	4,930.00	4,430.00	500.00
II	Buxhet dhe Financa	28,467.06	39,404.44	(10,937.38)
9	Të hyrat nga reklamimet publike	720.00	1,720.00	(1,000.00)
10	Licenca tjera për afarizëm	190.00	465.00	(275.00)
11	Taksa tjera administrative	-	110.00	(110.00)
12	Gjobat tjera	-	-	-
III	Shërbimet Publike	910.00	2,295.00	(1,385.00)
13	Ndërrim destinimi i tokës	-	-	-

14	Shfrytëzimi i pronës publike	-	-	-
IV	Bujqësia dhe Zhvillimi Rural	-	-	-
15	Të hyrat nga ushtrimi i veprimt. afariste	1,758.10	4,577.30	(2,819.20)
16	Gjoha nga Inspektoriati	-	-	
17	Licenca për pranim teknik të lokalit	10.00	-	10.00
V	Zhvillimi Ekonomik	1,768.10	4,577.30	(2,809.20)
18	Taksa komunale për leje ndërtimi	10.00	-	10.00
19	Taksa komunale për demolim	-	-	-
20	Taksë për bartjen e pronësisë	1,740.00	-	1,740.00
21	Shërbime të ndryshme kadastrale	1,276.00	1,148.00	128.00
22	Taksë për legalizim të objekteve	-	194.22	(194.22)
23	Taksa për regjistrimin e trashëgimisë	-	1,000.00	(1,000.00)
24	Shfrytëzimi i pronës publike	1,934.48	1,046.16	888.32
25	Të hyrat nga shitja e pasurisë	1,000.00	8,800.00	(7,800.00)
26	Gjohat nga inspektoriati	-	-	-
27	Të hyra nga konfiskimi	-	882.88	
28	Taksa tjera administrative	-		
29	Gjohat tjera	-	-	-
VII	Urbanizimi dhe Kadastr	5,960.48	13,071.26	(7,110.78)
30	Participimet në Arsim	3,528.00	3,255.00	273.00
VIII	Arsimi	3,528.00	3,255.00	273.00
31	Taksa për shërbimet sociale	30.00	59.00	(29.00)
32	Certifikata mjekësore	-	705.00	(705.00)
33	Participimet në shëndetësi	1,478.90	554.90	924.00
34	Inspektimi Higjeniko-Sanitar	-	-	-
VII	Shëndetësia dhe MS	1,508.90	1,318.90	190.00
A	TË HYRAT DIREKTE	43,749.54	65,244.90	(21,495.36)
35	Të hyrat nga dënimet në trafik		-	0.00
36	Të hyrat nga dënimet në gjykata		-	0.00
B	TË HYRAT INDIREKTE	-	-	0.00
	TOTALI I PËRGJITHSHËM (A + B)	43,749.54	65,244.90	(21,495.36)



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA - MUNICIPALITY
HANI I ELEZIT



Nr.01 01/2072 /2023

DATE:	10.03.2023
PËR:	KPF dhe Kuvendin e Komunës
PËRMES:	Kryetarit të Komunës z.Mehmet Ballazhi
NGA:	Drejtori i DSHPE-së, z.Arsim Dernjani
LËNDA:	Rregullore komunale per menaxhimin e mbeturinave



Të nderuar , me anë të kësaj shkrese po jua përcjelli Rregulloren Komunale per Menaxhimn e Mbeturinave për miratim.

Me respekt,

PROJEKT RREGULLORE KORNIZË¹

PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË KOMUNA²

(22.12.2022)

Përgatitur nga:



Sustainable Municipal Services (Waste Management)

Commissioned by the German Federal Ministry for Economic Cooperation and Development (BMZ), co-funded by the European Union

*Deutsche Gesellschaft für
Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH
Arkitekt Karl Gega No. 38
10000 Pristina
Republic of Kosovo
www.giz.de*

¹ Projekt Rregullorja për menaxhimin e mbeturinave është projekt rregullorë kornizë dhe secila nga komunat e Republikës së Kosovës mund ta përdorë për hartimin e Rregullores vetanake. Në këtë projekt rregullorë janë të përfshira të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë për komunat që dalin nga Ligji nr. 04/L-060 për mbeturina (Gazeta Zyrtare, nr.17, 29 qershor 2012) i cili është ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/L-060 për mbeturina (Gazeta Zyrtare, nr. 29, 1 shtator 2022). Njëkohësisht, janë marrë parasysh edhe Rregulloret përkatëse që kanë nxjerrë komunat për menaxhimin e mbeturinave dhe përmes kësaj rregulloreje avancohet procesi i menaxhimit të mbeturinave, duke u nisur nga fakti që “menaxhimi i mbeturinave” është një nga kompetencat vetanake të komunës i përcaktuar në Nenin 17 (f) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare, nr. 28, 4 qershor 2008).

Po ashtu, në këtë version të projektrregullores janë përfshirë komentet dhe sugjerimet e dhëna gjatë punëtorisë së mbajtur me datën 16.12.2022 si dhe komentet dhe sugjerimet e dhëna me shkrim nga zyrtarët përkatës të komunave.

Projekt rregullorja është hartuar duke i marrë parasysh standardet e përcaktuara në Udhëzimin Administrativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.03/2013 për standardet e hartimit të akteve normative si dhe Rregulloren (MAPL) Nr.02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës dhe Rregullore (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.

² Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, në Nenin 17.(f.) (Kompetencat vetanake), përcakton: Komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive, për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuar në legjislacionin e zbatueshëm, në fushat që vijnë: ...f) ... menaxhimin e mbeturinave,...



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Hanit të Elezit
Municipality of Elez Han

PROJEKT
RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË
KOMUNËN E HANIT TË ELEZIT

KOMUNA HANI I ELEZIT



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Komuna e Hanit të Elezit
Municipality of Elez Han

Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit

Në mbështetje të nenit 11, nenit 12.2 (c), dhe nenit 17 (f) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare, nr. 28, 4 qershor 2008), nenit 15.7, nenit 34 (paragrafi 2 dhe paragrafi 7) dhe nenit 80 të Ligjit nr. 04/L-060 për mbeturina (Gazeta Zyrtare, nr.17, 29 qershor 2012) i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 08/L-071 (Gazeta Zyrtare, nr. 29, 1 shtator 2022), si dhe **nenit 24 pika 24.1 të Statutit të Komunës së Hanit të Elezit, të datës 25.10.2018, në mbledhjen e mbajtur më ---.20XX, miraton këtë:**

RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË KOMUNËN E HANIT TË ELEZIT

KAPITULLI I -

DISPOZITA TË PËRGJTHSHME

Neni 1

Qëllimi

Me këtë rregullore përcaktohen rregullat dhe procedurat për organizimin dhe funksionimin e sistemit dhe standardet e shërbimit për menaxhimin e mbeturinave, hartimin e Planit komunal për menaxhimin e mbeturinave, krijimin e kushteve për zbatimin e tij si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e organit kompetent komunal për kryerjen e shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave, në territorin e Komunës së Hanit të Elezit, në mënyrë që të mbrohet shëndeti publik dhe të zvogëlohet ndikimi i mbeturinave në mjedis.

Neni 2

Fushëveprimi

1. Kjo Rregullore zbatohet:
 - 1.1. në territorin e Komunës së Hanit të Elezit, për aktivitetet e menaxhimit të mbeturinave, dhe
 - 1.2. ndaj të gjithë personave fizik dhe juridik, prodhuesve dhe zotëruesve të mbeturinave dhe operatorëve që merren me menaxhimin e mbeturinave në/dhe për territorin e Komunës së Hanit të Elezit,.

2. Dispozitat e kësaj rregulloreje nuk zbatohen për kategoritë e mbeturinave të përjashtuara sipas Ligjit për mbeturina dhe ligjeve dhe akteve të veçanta.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë këtë kuptim:
 - 1.1. **Administrata komunale** - të gjithë personat e punësuar nga autoriteti komunal siç përkufizohet në Ligjin nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale (Gazeta Zyrtare, nr. 28, 04 qershor 2008);
 - 1.2. **Deponi** - vendi i caktuar dhe rregulluar për mbeturina, ku do të vendosen mbeturinat nën apo mbi sipërfaqe të tokës;
 - 1.3. **Gazeta Zyrtare** – Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës;
 - 1.4. **Impiant** - objekti me pajisje të dedikuara për kryerjen e procesit të caktuar;
 - 1.5. **Komunë** - Komuna e Hanit të Elezit, njësi e vetëqeverisjes lokale, në territorin dhe me kufijtë administrativë të përcaktuar sipas Ligjit nr. 03/L-041 për kufijtë administrativ të komunave (Gazeta Zyrtare, nr. 26, 2 qershor 2008);
 - 1.6. **Konsumator** - personi i cili ka lidhur kontratë për shërbime me ofruesin e shërbimeve ose merr shërbime të caktuara sipas Ligjit për mbeturina dhe kësaj rregulloreje;
 - 1.7. **Kompostim** - është procesi i dekompozimit të kontrolluar të mbeturinave organike me qëllim të prodhimit të kompostit;
 - 1.8. **Kryetar** - Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit,
 - 1.9. **Kuvend** - Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit, ;
 - 1.10. **Ligj/Ligji për mbeturina** - Ligji nr. 04/L-060 për mbeturina (Gazeta Zyrtare, nr.17, 29 qershor 2012) i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 08/L-071 (Gazeta Zyrtare, nr. 29, 1 shtator 2022);
 - 1.11. **Ligji për Vetëqeverisjen Lokale** - Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare, nr. 28, 4 qershor 2008),
 - 1.12. **Ligji për bashkëpunim ndërkomunal** - Ligji nr. 04/L-010 për bashkëpunim ndërkomunal (Gazeta Zyrtare, nr. 7, 10 gusht 2011);
 - 1.13. **Leje përkatëse mjedisore** - nënkupton Leje mjedisore ose Leje mjedisore e integruar ose Leje mjedisore komunale, të përkufizuara sipas ligjit përkatës për mbrojtjen e mjedisit dhe Ligjit përkatës për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes;
 - 1.14. **Magazinim** - ruajtja e sigurt dhe e përkohshme e mbeturinave në objektet e parapara për këtë qëllim.
 - 1.15. **Mbeturina** - substancë apo objekt që prodhuesi apo zotëruesi e hedh, ka për qëllim ta hedh apo është i detyruar t'a hedh;
 - 1.16. **Menaxhimi i mbeturinave** - nënkupton aktivitetet përfshirë mbledhjen, grumbullimin, transportin, përpunimin-rikuperimin, klasifikimin, deponimin e mbeturinave, mbikëqyrjen e operacioneve të tilla dhe kujdesin, mirëmbajtjen e

mëvonshme të vendeve të depozitimit, si dhe veprimet e ndërmarra nga një tregtar ose ndërmjetësues;

- 1.17. **Mbeturina të rrezikshme** - nënkupton mbeturina që paraqesin një apo më shumë veti të rrezikshme të listuara në Shtojcën 1 të Ligjit për mbeturina;
- 1.18. **Mbeturina e parrezikshme** - mbeturinat që nuk paraqesin rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njeriut dhe që nuk posedojnë karakteristika të mbeturinave të rrezikshme;
- 1.19. **Mbeturina të veçanta** - mbeturinat të cilat për nga natyra e krijimit dhe trajtimit konsiderohen të veçanta sipas nenit 38.4, të Ligjit për mbeturina;
- 1.20. **Mbeturina inerte** - mbeturinat të cilat nuk pësojnë ndonjë ndryshim të rëndësishëm fizik, kimik dhe biologjik në vendet ku janë deponuar si:
 - 1.20.1. mbeturina inerte që nuk treten, nuk ndizen ose nuk reagojnë fizikisht apo kimikisht, nuk zbërthehen biologjikisht në kontakt me materiet tjera dhe nuk ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në mjedisin dhe shëndetin e njeriut;
 - 1.20.2. i tërë kullimi dhe përmbajtja ndotëse e mbeturinës, mbetjet ekotoksike duhet të jenë të vlerës së papërfillshme dhe të mos rrezikojnë cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore;
- 1.21. **Mbeturinat komunale** - nënkupton:
 - 1.21.1. mbeturinat e përziera dhe mbeturinat shtëpiake të grumbulluara veç e veç, duke përfshirë letrën dhe kartuçin, qelqin, metalet, plastikën, mbetjet bio, drunjtë, tekstilet, paketimin, pajisjet e mbeturinave elektrike dhe elektronike, bateritë dhe akumulatorët e mbeturinave, mbeturinat vëllimore, përfshirë dyshekët dhe mobilet;
 - 1.21.2. mbeturinat e përziera dhe mbeturinat e grumbulluara veçmas nga burimet e tjera, kur mbeturinat e tilla janë të ngjashme në natyrë dhe përbërje me mbeturinat shtëpiake;
 - 1.21.3. mbeturinat komunale nuk përfshijnë mbeturinat nga prodhimi, bujqësia, pylltaria, peshkimi, tankerët septike dhe rrjetet e kanalizimeve, si dhe nga trajtimi i ujërave të zeza, duke përfshirë llumrat e ujërave të zeza, mbeturinat e automjeteve ose mbeturinat e ndërtimit.
- 1.22. **Mbeturina komerciale** - nënkupton mbeturinat të cilat vijnë nga objektet që përdoren për qëllimet e tregut ose biznesit, sportit, edukimit, rekreacionit, por nuk përfshihen mbeturinat industriale dhe që nënkuptohet çdo mbeturinë e prodhuar nga një biznes duke përfshirë por jo kufizuar, në letër, karton, kanaçe, paketim me pakicë dhe mbështjellës ushqimi;
- 1.23. **Mbeturina ushqimore** - nënkupton mbeturinat e çdo substance apo produkti, qofte i përpunuar, i përpunuar pjesërisht ose i papërpunuar, e që pritet të konsumohet nga njerëzit, pijet, çamçakëzët dhe çdo substance, përfshirë edhe ujin, të përfshirë qëllimisht në ushqim gjatë prodhimit, përgatitjes ose trajtimit të tij.
- 1.24. **Mbeturinat nga ndërtimi dhe rrënimi** - nënkupton mbeturinat e krijuara nga aktivitetet e ndërtimit dhe prishjes;

- 1.25. **Mbeturina të vëllimshme** - nënkupton mbeturinat me përmasa të mëdha fizike nga pajisjet dhe makineritë, mobiliët, dhe mbeturina tjera të vëllimshme, përmasat e të cilave e pengojnë përdorimin e zakonshëm të grumbullimit, transportimit dhe largimit dhe kërkohet që kjo të bëhet në mënyrë të veçantë;
- 1.26. **Mbledhja** - mbledhje dhe transportim i mbeturinave duke përfshirë klasifikimin paraprak në lloje dhe magazinimin e mbeturinave për qëllime të bartjes deri në objekti për trajtim ose deponim të mbeturinave;
- 1.27. **Mbledhja e ndarë** - nënkupton mbledhjen, kur grumbullimi i mbeturinave bëhet në mënyrë të ndarë në lloje, të klasifikuar sipas natyrës dhe pajisjeve për të lehtësuar trajtimin specifik;
- 1.28. **Ministria** - Ministria përkatëse për mjedisin;
- 1.29. **Operatori** - nënkupton personin e pajisur me leje përkatëse mjedisore i cili në përputhje me dispozitat e Ligjit për mbeturina, Ligjit për prokurimin publik dhe legjislacionin përkatës në fuqi është përzgjedhur nga organi kontraktues i Komunës për ofrimin e shërbimeve publike për menaxhimin e mbeturinave, brenda territorit të Komunës së Hanit të Elezit,;
- 1.30. **Organe komunale** - nënkupton Kuvendin dhe Kryetarin e Komunës së Hanit të Elezit;
- 1.31. **Person** - person fizik ose juridik i cili është i involvuar në mënyrë të drejtpërdrejt ose tërthorazi, në proceset për menaxhimin e mbeturinave;
- 1.32. **Prodhuesi i mbeturinës** - çdo person, veprimtaria e të cilit krijon/prodhon mbeturinë ose çdonjëri që merret me para-procesim, përzierje apo operime tjera që rezultojnë në ndryshimin e natyrës apo përbërjen e mbeturinës;
- 1.33. **PKMM** - Plani komunal për menaxhimin e mbeturinave;
- 1.34. **Qeveria** - Qeveria e Republikës së Kosovës;
- 1.35. **Riciklimi** - çdo operim të përpunimit nga i cili materialet mbeturinë janë rikthyer në produkte, materiale, substanca qoftë si origjinale apo për qëllime tjera. Kjo përfshinë rikthimin e materialeve organike por nuk përfshinë përfitimin e energjisë dhe ripërpunimin në materiale që përdoren si karburante apo për operimet e mbulimit të mbeturinave;
- 1.36. **Statut** - Statuti i Komunës së Hanit të Elezit, i datës 25.10.2018;
- 1.37. **SMM** - Sektori/Njësia/Zyrtari përkatës për Menaxhimin e Mbeturinave, që vepron në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencë i cili zbaton politikat në fushën e mbrojtjes përcaktuar nga ministritë përkatëse dhe legjislacioni përkatës në fuqi për krijimin e një sistemi të qëndrueshëm për menaxhimin e mbeturinave komunale;
- 1.38. **Trajtimi i mbeturinave** - nënkupton të gjitha operacionet e përpunimit ose magazinimit, deponimit, përfshirë përgatitjet para përpunimit ose magazinimit, deponimit të mbeturinave;
- 1.39. **Zotëruesi i mbeturinës** - prodhuesi i mbeturinës apo personi që e posedon mbeturinën;
2. Termat tjerë të përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin e njëjtë me përkufizimet e dhëna në Ligjin për mbeturina, Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, dhe Statutin.

KAPITULLI II - SISTEMI PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

Neni 4

Parimet për menaxhimin e mbeturinave

1. Mbeturinat në Komunën e Hanit të Elezit,, mblidhen, grumbullohen, trajtohen dhe menaxhohen në përputhje me dispozitat e Ligjit për mbeturina, këtë rregullore, PKMM si dhe dispozitat e legjislacionit në fuqi.
2. Menaxhimi i mbeturinave në territorin e Komunës së Hanit të Elezit, bëhet duke u bazuar në respektimin e parimeve dhe sipas kuptimeve të përcaktuara në Nenin 5 të Ligjit për mbeturina, si në vijim:
 - 2.1. Parimi i afërsisë dhe vetë trajtimit;
 - 2.2. Parimi i vigjilencës dhe parandalimit;
 - 2.3. Parimi ku ndotësi paguan;
 - 2.4. Parimi për menaxhimin e mbeturinave i sistemuar sipas prioriteteve;
 - 2.5. Parimi i përgjegjësisë së prodhuesit dhe zotëruesit;
 - 2.6. Parimi i sigurimit financiar;
 - 2.7. Parimi për qasje të publikut në informata;
 - 2.8. Parimi i mbrojtjes së të drejtave në gjykatë.

Neni 5

Organizimi i menaxhimit të mbeturinave

1. Menaxhimi i mbeturinave në Komunën e Hanit të Elezit,, duhet të organizohet në atë mënyrë që të:
 - 1.1. mbulohet i tërë territorit të Komunës me shërbimin e grumbullimit të mbeturinave dhe arritjen e shkallës 100% të grumbullimit dhe transportimit;
 - 1.2. bëhet rritja e cilësisë, efikasitetit dhe qëndrueshmërisë dhe ngritja e kapaciteteve institucionale të menaxhimit të mbeturinave;
 - 1.3. rishikimi i procesit tarifar për të siguruar mekanizëm të qëndrueshëm të financimit;
 - 1.4. përmirësim i performancës operative dhe financiare të ofruesve të shërbimit;
 - 1.5. parandalimi dhe eliminimi i deponive ilegale të mbeturinave;
 - 1.6. parandalohet ndotja nga mbeturinat dhe t'i kufizohet ndikimi kur ajo ndodh në mënyrë që të mënjanohet çdo dëm a rrezik për mjedisin dhe për shëndetin, mirëqenien dhe sigurinë e jetës së njeriut;
 - 1.7. ruhet fauna dhe flora, mjedisi e peizazhi nga degradimi, dhe sidomos të ruhen burimet natyrore nga ndikimet e mbeturinave;
 - 1.8. sigurohen shërbime të rregullta dhe të besueshme drejt mbledhjes së mbeturinave dhe trajtimit të tyre të ndarë, në të gjitha fazat e administrimit të tyre dhe të mos përzihen me mbeturinat e rrezikshme;

- 1.9. përmirësohet qasja në shërbimet e menaxhimit të mbeturinave nga popullata në zonat urbane dhe rurale në përputhje me politikat qeveritare dhe PKMM;
- 1.10. zbatojnë shërbimet bazë të menaxhimit të mbeturinave drejt qëndrueshmërisë dhe mbeturinat t'i nënshtrohen sa më shumë reduktimit, riciklimit dhe ripërdorimit;
- 1.11. zhvillohet potenciali ekonomik i ekonomisë qarkore, me përfshirjen e grupeve të cenueshme;
- 1.12. parandalojnë dhe reduktojnë prodhimin e mbeturinave me qëllim të parandalimit të ndotjes së mjedisit dhe mbrojtjes së shëndetit të njeriut, nga prodhuesit dhe zotëruesit e mbeturinave;
- 1.13. rritet ekspertiza specifike sektoriale në komunë dhe trajtimi i mbeturinave tu përmbahet standardeve profesionale dhe të bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit për mbeturina, këtë rregullore dhe legjislacionin përkatës në fuqi;
- 1.14. përdoren vetëm teknikat dhe metodat më të mira të mundshme të bazuara në kritere mjedisore për ndarjen, grumbullimin, transportimin, ruajtjen, përpunimin dhe asgjësimin e mbeturinave;
- 1.15. realizohet një cikël sa më i shkurtër për administrimin e mbeturinave me qëllim që të zvogëlohet koha e ekspozimit të tyre në mjedis;
- 1.16. dëmshpërblehet dhe të rehabilitohet nga personat fizike dhe juridik, ndotja dhe dëmtimi që shkaktohet prej tyre nga keqadministrimi i mbeturinave.

Neni 6

Reduktimi, Ripërdorimi dhe riciklimi i mbeturinave

1. Menaxhimi i mbeturinave në Komunën e Hanit të Elezit,, duhet të organizohet në atë mënyrë që mbeturinat të:
 - 1.1. **Reduktohen** - prodhuesit dhe zotëruesit e mbeturinave të parandalojnë dhe reduktojnë prodhimin e mbeturinave, me qëllim të parandalimit të ndotjes së mjedisit dhe mbrojtjes së shëndetit të njeriut;
 - 1.2. **Ripërdoren** - mbeturinat, kur ka mundësi, të ripërdoren apo përpunohen si lëndë e parë sekondare dhe si lëndë për përfitimin e energjisë;
 - 1.3. **Riciklohen** - mbeturinat, kur është e mundur të riciklohen me qëllim që të përdoren si lëndë e parë sekondare.
 - 1.4. **Riparim**- mbeturinat, kur është e mundur të riparohen me qëllim që të përdoren përsëri;
 - 1.5. **Ripunim** -mbeturinat, kur ka mundësi, të ripunohen me qëllim që të përdoren përsëri.

Neni 7

Trajtimi i barabartë

Komuna, autoritetet komunale dhe operatori duhet të trajton në mënyrë të barabartë të gjithë konsumatorët, prodhuesit dhe zotëruesit e mbeturinave në territorin e komunës së Hanit të Elezit, dhe nuk mund të diskriminojë asnjë person në cilëndo prej bazave të përcaktuara në Ligjin për mbrojtje nga diskriminimi.

KAPITULLI III-PLANI KOMUNAL PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

Neni 8

Dokumentet për planifikimin dhe menaxhimin e mbeturinave

1. Dokumentet për planifikimin dhe menaxhimin e mbeturinave, siç përcaktohet në Ligjin për mbeturina, janë:
 - 1.1. Strategjia e Republikës së Kosovës për menaxhimin e mbeturinave (Strategjia), e cila propozohet nga ministria dhe miratohet nga Qeveria, për periudhën kohore dhjetë (10) vjeçare, dhe rishqyrtohet së paku në pesë (5) vjet;
 - 1.2. Plani i Republikës së Kosovës për menaxhimin e mbeturinave, i cili nxirret nga ministria për periudhën kohore prej pesë (5) vitesh dhe i cili rishqyrtohet sipas nevojë;
 - 1.3. Plani komunal për menaxhimin e mbeturinave (PKMM), i cili nxirret nga komuna në pajtim me nenin 9 të kësaj rregulloreje;
 - 1.4. Plani për menaxhimin e mbeturinave i cili nxirret nga zotëruesi i mbeturinave për periudhën pesë (5) vjeçare;
 - 1.5. Plani për menaxhimin e mbeturinave nga operatori për menaxhimin e mbeturinave, i cili nxirret nga operatorët për periudhën pesë (5) vjeçare.

Neni 9

Plani komunal për menaxhimin e mbeturinave

1. PKMM miratohet nga Kuvendi, dhe duhet të:
 - 1.1. jetë i harmonizuar me Planin e Republikës së Kosovës për menaxhimin e mbeturinave;
 - 1.2. nxirret për periudhën kohore prej pesë (5) vitesh dhe i cili rishqyrtohet sipas nevojë;
 - 1.3. hartohet në bashkëpunim me operatorët dhe në një proces publik dhe gjithëpërfshirës me pjesëmarrje të qytetarëve, institucioneve dhe organizatave të ndryshme joqeveritare;
 - 1.4. miratohet nga Kuvendi.

2. Përmbytja e PKMM, duhet të jetë në pajtim me paragrafin 6 të Nenit 10 të Ligjit për mbeturina.
3. Sipas nevojës dhe në marrëveshje, Komuna e Hanit të Elezit, së bashku me një a më shumë komuna mund të nxjerrin planin e përbashkët lokal për menaxhimin e mbeturinave.
4. Përgjegjës për zbatimin e PKMM janë organet komunale të përcaktuara në këtë rregullore dhe në PKMM.

Neni 10

PKMM dhe masat për parandalimin, reduktimin, ripërdorimin dhe riciklimin e krijimit të mbeturinave

(Opsioni 2: PKMM dhe masat për parandalimin, reduktimin, ripërdorimin, riciklimin, riparimin dhe ripunimin e krijimit të mbeturinave)

1. Në PKMM duhet të integrohen procedurat dhe programet, në të cilat përcaktohen masat për parandalimin e krijimit të mbeturinave, për të ndikuar që gradualisht të ndryshohen shprehitë e konsumatorëve për prodhim të mbeturinave.
2. Masat, sipas paragrafit 1 të këtij neni, përfshijnë por nuk kufizohen në veprimet si në vijim:
 - 2.1. rritja e ndërgjegjësimit të konsumatorëve për çështjet e reduktimit, ripërdorimit dhe riciklimit të krijimit të mbeturinave; (Opsioni 2: rritja e ndërgjegjësimit të konsumatorëve për çështjet e reduktimit, ripërdorimit, riciklimit, riparimit dhe ripunimit i të krijimit të mbeturinave;)
 - 2.2. përgatitja e ambientit për futjen graduale të tarifave volumetrike për të dekurajuar prodhimin e mbeturinave;
 - 2.3. promovimi dhe facilitimi i skemës së kompostimit individual;
 - 2.4. promovimi përmes politikave të favorshme të hapjes së stacioneve rimbushëse dhe dyqaneve “zero mbeturina”;
 - 2.5. përgatitja e ambientit, dhe në koordinim me Qeverinë, për largimi nga tregu i artikujve një përdorimesh të tillë si qeset plastike dhe paketimeve një përdorimesh;
 - 2.6. promovimi dhe facilitimi i restoranteve dhe objekteve gastronomike “zero mbeturina” për të reduktuar mbeturinat;
 - 2.7. futja e stimuljeve të përshtatshëm fiskal, tarifave preferenciale, kontraktimi dhe prokurimi publik preferencial nga këto subjektet me “zero mbeturina”.
3. Në PKMM duhet të integrohen procedurat dhe programet, në të cilat përcaktohen masat për reduktimin, ripërdorimin, riciklimin, riparimin dhe ripunimin e mbeturinave komunale por edhe kategorive tjera të mbeturinave, me theks të veçantë në mbeturinat nga ndërtimi dhe rrënimi, mbeturinat e vëllimshme, mbeturinat e veçanta.
4. Masat, sipas paragrafit 1 të këtij neni, përfshijnë por nuk kufizohen në veprimet si në vijim:
 - 4.1. aktivitetet vetëdijësuese për reduktimin, ripërdorimin, riciklimin, riparimin dhe ripunimin të mbeturinave;

- 4.2. përgatitjet për sigurimin e infrastrukturës për ndarjen e mbeturinave në burim dhe për hapjen e qendrës së grumbullimit dhe ripërdorimit, ripërdorimit, riciklimit, riparimit dhe ripunimit të produkteve të hedhura;
- 4.3. analizat e kompozicionit të mbeturinave dhe potencialit të mbeturinave që mund të riciklohen, ripërdorën, riparohen dhe ripërpunohen dhe shikimi i mundësisë për hapjen e qendrës lokale/rajonale të kompostimit dhe për hapjen e qendrës për ripërdorimin dhe ripërpunimin e mbeturinave nga ndërtim dhe rrënim;
- 4.4. përgatitja e ambientit për zbatimin e skemave të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit dhe zotëruesit të mbeturinave.

Neni 11

PKMM dhe fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera

Në PKMM duhet të integrohen procedurat dhe përcaktohen masat për menaxhimin e mbeturinave gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme siç përcaktohet në Kushtetutë, si dhe për masat për zbatimin e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës gjatë fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera, siç përcaktohet në Ligjin Nr. 04/-L-027 për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera (Gazeta Zyrtare, nr. 22, 19 tetor 2011).

KAPITULLI -IV - DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

Neni 12

Spektori për Menaxhimin e Mbeturinave

1. Spektori/Njësia/Zyrtari përkatëse për Menaxhimin e Mbeturinave (SMM), vepron në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencë
2. SMM bashkëpunon me ministrin dhe me palët e interesuara për hartimin e dokumenteve për planifikimin dhe menaxhimin e mbeturinave si dhe zbaton politikat në fushën e mbrojtjes, të përcaktuara nga ministritë përkatëse dhe legjislacioni përkatës në fuqi, për krijimin e një sistemi të qëndrueshëm për menaxhimin e mbeturinave komunale.
3. SMM bashkëpunon me policinë, prokurorinë, gjykatat, dhe institucionet tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 13

Detyrat dhe përgjegjësitë e Spektorit për menaxhimin e mbeturinave

1. SMM, ka detyrat dhe përgjegjësitë si në vijim:
 - 1.1. planifikon, rregullon, udhëheqë dhe të zbaton aktivitete për menaxhimin e mbeturinave brenda territorit të komunës së Hanit të Elezit,;
 - 1.2. harton, siguron dhe raporton zbatimin e PKMM, në pajtim me këtë rregullore dhe legjislacionin përkatës në fuqi;

- 1.3. udhëzon dhe mbikëqyrë ofruesit e shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave komunale;
 - 1.4. planifikon buxhetin për funksionimin e duhur të menaxhimit të mbeturinave;
 - 1.5. propozon tarifën për menaxhimin e mbeturinave dhe mënyrën e arkëtimit të mjeteve financiare, duke përfshirë edhe tarifën e shërbimit për zbrazjen e kontejnerëve të veçantë për hedhjen e mbeturinave gjatë ndërtim-rrënimin dhe mbeturinave të vëllimshme;
 - 1.6. siguron faturimin e taksës për mbeturina, dhe për organizimin dhe shpërndarjen e faturave;
 - 1.7. siguron kushtet e veprimit dhe operimit për operatorët publikë dhe privatë;
 - 1.8. organizon menaxhimin e mbeturinave nga sipërfaqet publike;
 - 1.9. mbikëqyrë mbledhjen, transportimin deri në deponi të mbeturinave komunale, komerciale, inerte, të vëllimshme, nga ndërtimet dhe rrënimet, ushqimore, si dhe llojeve tjera të mbeturinave të cilat janë në kompetencë të nivelit lokal;
 - 1.10. njofton publikun për menaxhimin e mbeturinave dhe promovon ngritjen e vetëdijesimit publik - pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në menaxhimin e mbeturinave, në bashkëpunim me njësitë përkatëse në komunë;
 - 1.11. promovon minimizimin e mbeturinave reduktim, ripërdorim, riciklim, riparim dhe ripunim (5R), kompostimin shtëpiak etj.;
 - 1.12. identifikon pikat/deponitë ilegale të hedhjes së mbeturinave dhe siguron evitimin e tyre;
 - 1.13. në bashkëpunim me njësitë tjera komunale siguron kushte veprimi dhe operimi për operatorin;
 - 1.14. harton raportet për menaxhimin e mbeturinave, përfshi raporte vjetore për menaxhimin e mbeturinave raportet për shkallën e arkëtimit të tarifës për mbeturina, sipas kërkesave që dërgohet në Ministri si dhe raporteve tjera të përcaktuar në Ligjin për mbeturina dhe këtë rregullore;
 - 1.15. bënë monitorimin mjedisor të deponisë së mbeturinave ,
 - 1.16. në emër të komunës përgatit dhe dërgon informacionet dhe rekomandimet e kërkuara nga Ministria, lidhur me menaxhimin e mbeturinave.
2. SMM, sipas nevojës dhe në bashkëpunim me dhe përmes operatorit të kontraktuar për menaxhimin e mbeturinave komunale, përcakton:
- 2.1. vendndodhjen e pikave të grumbullimit të mbeturinave;
 - 2.2. mënyrën e hudhjes së mbeturinave;
 - 2.3. lokacionin për vendosjen e kontejnerëve dhe mënyrën e mirëmbajtjes së tyre, kur është e nevojshme një gjë e tillë;
 - 2.4. kushtet për mënyrën e mbledhjes, ndarjes, përpunimit dhe riciklimit, të mbeturinave;
 - 2.5. orarin dhe dinamikën për mbledhjen e mbeturinave, dhe sipas nevojë autorizon operatorin që të bëjë mbledhjen e mbeturinave edhe jashtë orarit dhe dinamikës së paraparë;
 - 2.6. mënyrat për transportim të mbeturinave komunale;

3. SMM, përkujdeset që të themelohet komisioni i ankesave në kuadër të administratës komunale, i cili do të shqyrton ankesat e konsumatorëve sa u përket shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave, tarifave dhe mënyrës së arkëtimit të tyre.

Neni 14

Të drejtat e prodhuesit apo zotëruesit të mbeturinave

1. Çdo prodhues apo zotërues i mbeturinave dhe çdo konsumator ka të drejtë:
 - 1.1. qasjeje në shërbimet publike për hedhjen dhe grumbullimin e mbeturinave;
 - 1.2. të informohet dhe të kërkojë informata për menaxhimin e mbeturinave
 - 1.3. të marrë pjesë dhe të kontribuojë në politikat për menaxhimin e mbeturinave;
 - 1.4. të bëjë ankesë, ndaj shërbimit të ofruar dhe të marrë përgjigje në ankesën e bërë.

Neni 15

Detyrat dhe përgjegjësitë e prodhuesit apo zotëruesit të mbeturinave

1. Çdo prodhues apo zotërues i mbeturinave ka detyrat dhe përgjegjësitë si në vijim:
 - 1.1. të regjistrohet në listat e shërbimit të konsumatorëve për mbledhjen dhe bartjen e mbeturinave dhe të përditësojnë të dhënat në rastet e ndryshimit të adresës;
 - 1.2. të bashkëpunojnë me autoritetet publike për të siguruar një mjedis të pastër;
 - 1.3. të bëjë përpjekje për minimizimin e mbeturinave përmes reduktimit, ripërdorimit, riciklimit, riparimit dhe ripunimit (5R) kompostimit shtëpiak dhe formave tjera të mundshme);
 - 1.4. t'i respektojë rregullat e përcaktuara me legjislacionin përkatës në fuqi dhe PKMM;
 - 1.5. të paguaj për shërbimin e ofruar në bazë të tarifës së miratuar nga Komuna;
 - 1.6. t'i hedhin mbeturinat e tyre në vende dhe sipas sistemit të caktuar nga ana e Komunës për mbledhjen e mbeturinave, ndërsa mbeturinat e rrezikshme t'i ndajnë dhe t'i dorëzojnë në vendet e caktuara për to, në pajtim me legjislacionin në fuqi;
 - 1.7. të bëjnë ndarjen e mbeturinave sipas sistemit të caktuar nga komuna, me qëllim të trajtimit dhe riciklimit të tyre si dhe t'i hedhin ose dorëzojnë mbeturinat e një lloji:
 - 1.7.1. në shporta, kontejnerë apo vende dhe mënyra të përcaktuara për atë lloj;
 - 1.7.2. në pika ose qendra grumbulluese të përcaktuara për atë lloj; ose
 - 1.7.3. te operatori;
 - 1.8. ta njoftojnë SMM kur prodhojnë mbeturina gjatë meremetimit apo rrënimit të objekteve dhe të largojnë këto mbeturina, nga hapësirat ose vendet publike, në pajtim me legjislacionin në fuqi.
2. Prodhuesit apo zotëruesit e mbeturinave të veçanta, mbeturinave të rrezikshme dhe mbeturinave medicinale, janë të detyruar të respektojnë legjislacionin në fuqi për trajtimin e

këtyre mbeturinave dhe të përdorin sistemin e ndarjes së kontejnerëve dhe t'i dorëzojnë ato mbeturina në vendet e caktuara për to.

3. Prodhuesit apo zotëruesit e mbeturinave, për objektet dhe pajisjet për menaxhimin e mbeturinave, për të cilat sipas Ligjit për mbeturina, është e nevojshme të merret cilado nga lejet mjedisore, janë të detyruar të nxjerrin Planin për menaxhimin e mbeturinave, në pajtim me Neni 11 të Ligjit për mbeturina.

KAPITULLI -V -AKTIVITETET PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

Neni 16

Grumbullimi i mbeturinave

1. Grumbullimi i mbeturinave bëhet vetëm në vendet dhe mënyrat e mbledhjes së mbeturinave të cilat caktohen nga Komuna.
2. Ndryshimi i vendndodhjes së vendeve të mbledhjes së mbeturinave dhe hudhja e mbeturinave në kundërshtim me mënyrën e përcaktuar nga komuna, përbën shkelje dhe ndëshkohet sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 17

Kontejnerët dhe shportat për mbeturina

1. Me qëllim të mbajtjes sa më të mirë të pastërtisë në sipërfaqe publike, vendoset numër i mjaftueshëm i shportave apo kontejnerëve për mbeturina.
2. Llojin, mënyrën, vendin dhe numrin e shportave apo kontejnerëve dhe të mjeteve tjera në sipërfaqe publike, e cakton SMM, në bashkëpunim me operatorin.
3. Numri i kontejnerëve duhet të përshtatet me numrin e banorëve në objektet e përbashkëta të banimit dhe llojin e mbeturinave që krijojnë.
4. Kontejnerët për mbeturina duhet të vendosen në vende të dukshme dhe të përshtatshme.
5. Kontejnerët, nëse paraqitet nevoja, duhet të kenë mbishkrime të dukshme që udhëzojnë për klasifikimin e mbeturinave.
6. Personat juridik dhe fizik që marrin shërbimet derë me derë, hedhin mbeturinat sipas mënyrës që caktohet nga SMM.
7. Ndërmarrja së cilës i besohen punët e mirëmbajtjes së rregullt të parqeve, sheshe dhe në vende tjera, është e obliguar të vendosë dhe të mirëmbajë numër të mjaftueshëm të kontejnerëve apo shportave për mbeturina.
8. Çerdhet, kopshtet dhe shkollat, publike e private, duhet të përdorin sistemin e disa kontejnerëve apo shportave për të edukuar fëmijët dhe nxënësit me normat e rregullat bashkëkohore të trajtimit të ndarë të mbeturinave.
9. Për mirëmbajtjen dhe pastrimin e kontejnerëve për mbeturina, në sipërfaqe publike, kujdeset operatori.
10. Personat juridik dhe qytetarët janë përgjegjës për mirëmbajtjen dhe pastrimin e kontejnerëve për mbeturina apo vendeve ku i hedhin mbeturinat.

Neni 18

Hedhja dhe mbledhja e mbeturinave

1. SMM përkujdeset që të bëhen publik orari i hedhjes dhe mbledhjes së mbeturinave.
2. Në procesin e vendimmarrjes për caktimin e orarit të hedhjes dhe mbledhjes së mbeturinave, ftohen të marrin pjesë operatorët, personat juridik dhe fizik, OJQ-të dhe publiku i interesuar.
3. Secili person ka të drejtë të kërkojë të informohet për ecurinë e procesit të hedhjes dhe mbledhjes së mbeturinave.
4. Sistemimi dhe hedhja e mbeturinave, nga prodhuesit apo zotëruesit e mbeturinave bëhet vetëm në mënyrën e caktuar dhe sipas orarit që ka caktuar komuna.
5. Kalimtarët, mbeturinat e çastit si ambalazhe të ndryshme, i hedhin vetëm në shportat apo kontejnerët e vendosur në hapësira publike ose që ndodhen para dyqaneve. Ndalohet hedhja e tyre në rrugë, në trotuare apo në ambiente të tjera publike.
6. Mbeturinat që dalin nga krasitja e pemëve, e hardhive, nga punimet në oborre, në lulishte e parqe, para se të dërgohen në vendet e mbledhjes së këtyre mbeturinave, priten në pjesë të vogla e palosen për të mos bllokuar kazanët dhe vështirësuar transportin.
7. Hedhja e mbeturinave jashtë këtij rregulli, përbën shkelje dhe ndëshkohet sipas legjislacionit në fuqi.
8. Hedhja e mbeturinave të rrezikshme, mbeturinave te veçanta, mbeturinave industriale, mbeturinave inerte, mbeturinave medicinale, mbeturinave nga ndërtimi dhe rrënimi, si dhe mbeturinave të tjera që nuk konsiderohen si mbeturina komunale sipas Ligjit dhe nga kjo rregullore, duhet të bëhet në pikat e veçanta të caktuara nga Komuna për këtë qëllim, dhe në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.
9. SMM përkujdeset që komuna të sigurojë vendin në të cilin do të bëhet hedhja e mbeturinave nga ndërtimi dhe rrënimi, dhe mbeturinave tjera të përcaktuar në paragrafin 8 të këtij neni.

Neni 19

Transportimi i mbeturinave

1. Transportimi i mbeturinave për në vendet e deponimit bëhet nga komuna ose operatori.
2. Transportuesit e mbeturinave bëjnë transportimin e mbeturinave në bazë të kushteve të përcaktuara me legjislacionin përkatës në fuqi.

3. Bartja e mbeturinave bëhet gjatë ditës dhe gjatë natës, në orët e mbrëmjes apo herët në mëngjes, sipas orarit dhe dinamikës për mbledhjen e mbeturinave të caktuar nga SMM, i cili bëhet publikë në ueb faqen e komunës.
4. Transportimi i mbeturinave në orët e pikut të aktiviteteve qytetare, është i ndaluar dhe ndëshkohet sipas legjislacionit në fuqi.
5. Gjatë bartjes së mbeturinave mjetet me të cilat ato barten, patjetër duhet të jenë të mbyllura ose të mbuluara, në mënyrë që të pengohet derdhja apo rishpërndarja e mbeturinave gjatë transportit deri në deponinë e caktuar.
6. Nëse ndotja ndodhë gjatë transportimit të mbeturinave, transportuesi është i detyruar që vendin e ndotur ta kthejë në gjendje të mëparshme.
7. Nëse mbeturina e transportuara, nuk pranohet në deponinë e destinuar, transportuesi duhet ta kthejë mbeturinën në vendin ku është marrë dhe të njoftojë SMM.

Neni 20

Deponitë e mbeturinave

Deponimi i mbeturinave në Komunën e Hanit të Elezit, në varshmëri të karakteristikave të mbeturinave, bëhet vetëm në deponitë e licencuara dhe të lejuara përkatëse si dhe sipas llojit përkatës të mbeturinave, që mund të jenë deponi për mbeturinat e rrezikshme; deponi për mbeturinat jo të rrezikshme; deponi të mbeturinave inerte, në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi për menaxhimin e deponive.

KAPITULLI VI - OPERATORËT PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

Neni 21

Operatorët për menaxhimin e mbeturinave

1. Menaxhimi i mbeturinave bëhet përmes kontratave të veçanta me një apo më shumë operator publik ose privat për menaxhimin e mbeturinave, të cilët duhet të jenë të pajisur me leje përkatëse mjedisore për menaxhimin e mbeturinave dhe të cilët do të veprojnë sipas kushteve të përcaktuara me licencën për menaxhimin e mbeturinave të lëshuar në pajtim me legjislacionin në fuqi.
2. Operatorët për menaxhimin e mbeturinave mund të jenë institucionet, kompanitë publike ose private të regjistruara sipas ligjit, të cilët shërbimet për komunën për menaxhimin e mbeturinave e kryejnë në bazë të kontratës.
3. Organi kontraktues i Komunës, duke u bazuar në dispozitat e ligjit përkatës të prokurimit, mund të përcaktojnë të gjitha kushtet nevojshme për përzgjedhjen e operatorit për menaxhimin e

mbeturinave komunale, dhe mbeturinave: inerte, komerciale, të vëllimshme dhe mbeturinat nga ndërtimet dhe rrënimet, brenda territorit të Komunës së Hanit të Elezit.

4. Komuna mund të përzgjedhë për operator një ndërmarrje në pronësi të Komunës sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 22

Menaxhimi i mbeturinave me partneritet publiko-privat

Menaxhimi i mbeturinave, ndërtimi, shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e impianteve dhe objekteve për menaxhimi e mbeturinave mund të epet në formën e partneritetit publiko-privat sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 23

Kontrata me operatorin

1. Kontrata me operatorin duhet të specifikoj, së paku:
 - 1.1. Territorin e saktë ku kryhen shërbimet;
 - 1.2. mënyrën e ofrimit të shërbimeve;
 - 1.3. specifikimin e pajisjeve për trajtim;
 - 1.4. mënyrën e raportimit në komunë;
 - 1.5. çështjet tjera që kërkohen sipas Ligjit, këtë rregullore dhe legjislacionit përkatës në fuqi.
2. Operatori i kontraktuar nga organi kontraktues, për ofrimin e shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave, është i obliguar që të veprojë sipas Ligjit, kontratës, kësaj rregulloreje dhe legjislacionit përkatës në fuqi dhe përmbush të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e operatorit të përcaktuar në Ligj dhe legjislacionin përkatës në fuqi.

KREU VII- KATEGORIZIMI I KONSUMATORËVE DHE TARIFAT PËR SHËRBIMET E MENAXHIMIT TË MBETURINAVE

Neni 24

Kategorizimi i konsumatorëve dhe caktimi i tarifave për menaxhimin e mbeturinave

1. Konsumatorët, gjegjësisht prodhuesit apo zotëruesit të mbeturinave, kategorizohen si në vijim:
 - 1.1. Konsumatorët e amvisërive;
 - 1.2. Konsumatorët komerciale dhe industriale;
 - 1.3. Konsumatorët institucionale.

2. Kuvendi aprovon nënkategoritë e konsumatorëve dhe tarifat për menaxhimin e mbeturinave. (Opsioni 2: Në rastet kur komunat vendosin që nënkategoritë dhe tarifat për menaxhimin e mbeturinave të caktohen në rregullore atëhere ky paragraf riformulohet si në vijim: Nënkategoritë e konsumatorëve dhe tarifat për menaxhimin e mbeturinave janë të përcaktuara në Shtojcën 1 të kësaj Rregulloreje.)
3. Gjatë caktimit të tarifave duhet marrë parasysh shërbimit për secilën kategori, dhe duke marrë parasysh ndikimin e tarifave në mjedisin jetësor dhe rekomandimin e SMM dhe operatorëve.
4. SMM në bashkëpunim me operatorin krijojnë, mirëmbajnë dhe përditësojnë listën e konsumatorëve, duke përfshirë edhe kategorizimin dhe nënkategorizimin e tyre.

Neni 25

Faturimi i mbeturinave, Caktimi i tarifave dhe mënyra arrkëtimit

1. Faturimi i mbeturinave bëhet në baza vjetore, kurse fatura i dorëzohet konsumatorit më së largu deri më 31 mars të vitit kalendarik. (Opsioni 2: Faturimi i mbeturinave bëhet në bazë mujore kurse fatura i dorëzohet konsumatorit, më së largu deri më datën 10 të muajit pasues. Konsumatori obligohet që të paguajë faturën e mbeturinave për çdo muaj të vitit.)
2. Konsumatori obligohet të paguaj faturën e mbeturinave, në katër këste brenda vitit, si më poshtë:
 - 2.1. Kësti i parë janar – mars;
 - 2.2. Kësti i dytë prill – qershor;
 - 2.3. Kësti i tretë korrik- shtator;
 - 2.4. Kësti i katërt tetor – dhjetor.
3. Konsumatorët paguajnë tarifën për menaxhimin e mbeturinave dhe sipas shumës së përcaktuar nga Kuvendi.
4. SMM e rishikon lartësinë e tarifave të paktën çdo tri vjet, duke llogaritur koston e shërbimeve, dhe i rekomandon Kuvendit ndryshimet që i shoh të nevojshme.
5. Konsumatorët mund të parapagujnë tarifën për gjashtë muaj ose një vit. Nëse konsumatorët paguajnë në këtë mënyrë tarifën kanë zbritjet si në vijim:
 - 5.1. 5% për qind për konsumatorët që parapagujnë tarifën për gjashtë muaj; dhe
 - 5.2. 10% për qind për konsumatorët që parapagujnë tarifën për një vit.
6. Komuna i cakton tarifën për mbeturina, varësisht nga lloji i tyre në bazë të rregullores për menaxhimin e mbeturinave,
7. Mënyra e caktimit të tarifave të cekura në nenin 6, dhe të arrkëtimit ,në raste specifike do të rregullohet me vendim, të cilin do të nxjerr kryetari i Komunës .

Llojet e Shërbimit	Çmimi/Muaj	Çmimi për kontinjer 120 Litra	Çmimi për kontenjer 1100 L
Ekonomit familjare/amëvisrit	6.50		
Bizneset e vogla	10.40		
Institucionet Publike		1x6.50për zbrazje	1x16.90 për zbrazje
Ndërmarrjet e mëdha dhe ndërmarrjet me shërbime të			

veqanta si:SharrCem, Bankat, Terminali Doganor, Kosova Plast, fabrika për përpunimin e mishit, mishtoret etj) do të rregullohen me kontratë të veqant.			
--	--	--	--

KREU VIII -INFORMIMI, PROMOVIMI DHE RAPORTI PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

Neni 26

Seanca/t vjetore për çështjet e menaxhimit të mbeturinave

1. Kuvendi organizon të paktën një (1) seancë vjetore, apo se paku në një seancë e diskuton në rend të ditës çështjet e menaxhimit të mbeturinave.
2. Në seancën/at vjetore ku diskutohet për menaxhimin e mbeturinave, secili drejtor i drejtorisë komunale raporton për çështjet, veprimet dhe masat që janë në përgjegjësinë e tij dhe që kanë të bëjnë dhe që ndërlidhen me menaxhimin e mbeturinave, si dhe paraqesin aktivitetet që janë ndërmarrë për realizimin e PKMM.
3. Në seancën/at vjetore për menaxhimin e mbeturinave, ku diskutohet për menaxhimin e mbeturinave, marrin pjesë edhe përfaqësues të shoqërisë civile.
4. Seanca/at vjetore për menaxhimin e mbeturinave organizohen në koordinim me SMM.

Neni 27

Ditët e Komunës së pastër

1. Nën patronatin e Kryetarit organizohen dhe mbahen "Ditët e Komunës së pastër".
2. Gjatë këtyre ditëve organizohen aktivitete të ndryshme me pjesëmarrjen e subjekteve të ndryshme që merren me mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut në territorin e Komunës.
3. Kryetari, me vendim, cakton datat për "Ditët e Komunës së pastër", dhe përcakton përgjegjësitë e mekanizmave përkatëse për detyrat e tyre në këto ditë dhe aktivitetet konkrete që duhet ndërmarrë.
4. Në ditët e Komunës së pastër, Kryetari mund të vendos që të bëhet pa pagesë grumbullimi, transportimi dhe deponimi i mbeturinave të vëllimshme.

Neni 28

Informimi dhe promovimi

1. Komuna e Hanit të Elezit, është transparente ndaj palëve të interesuara për dhënien e informatave për menaxhimin e mbeturinave.

2. Zyra përkatëse për informim në Komunën e Hanit të Elezit,, në bashkëveprim me SMM, përmes fushatave, ligjëratave publike si dhe materialeve të ndryshme promovuese për ngritjen e vetëdijes për menaxhimin e mbeturinave dhe mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut në territorin e Komunës së Hanit të Elezit,, krijojnë një sistem të informimit për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut dhe informata të tjera të cilat janë në interes të qytetarëve.
3. Organizatat e shoqërisë civile inkurajohen dhe përkrahen që të monitorojnë, promovojnë dhe informojnë për menaxhimin e mbeturinave.

Neni 29

Ngritja e vetëdijes për rëndësinë dhe dobitë e menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave.

Zyra përkatëse për informim në Komunën e Hanit të Elezit,, në bashkëveprim me SMM, shoqërinë civile dhe konsumatorët promovojnë konceptin e 5R (reduktim, ripërdorim, riciklim, riparim dhe ripunim) për të synuar që gradualisht në Komunën e Hanit të Elezit, të fillojë ndarja e mbeturinave (nga ekonomi familjare, tek shkollat dhe institucionet, dhe biznese), të ngritë vetëdijen e qytetarëve dhe bizneseve rreth përfitimeve për ndarje të mbeturinave dhe të krijojë infrastrukturë për zhvillim ekonomik lokal, pra të krijojë mundësi qytetarëve që të krijojnë biznese financiarisht të qëndrueshme në sektorin e menaxhimit të mbeturinave.

Neni 30

Raporti vjetor për menaxhimin e mbeturinave

1. SMM monitoron zbatimin e kësaj rregulloreje dhe harton raporte vjetore për menaxhimin e mbeturinave.
2. Obligohen të gjitha njësitë përkatëse të komunës për bashkëpunimin dhe ofrimin e të dhënave të kërkuara nga SMM.
3. Raporti vjetor për menaxhimin e mbeturinave duhet dorëzuar në Ministri, deri më 31 mars të vitit vijues, siç është përcaktuar në Nenin 58 të Ligjit për mbeturina.
4. Operatorët që merren me menaxhimin e mbeturinave paraqesin Raportin vjetor deri më 31 mars të vitit vijues. Raporti paraqitet në Komunë dhe në Ministri.
5. Raporti nga paragrafët 3. dhe 4. të këtij neni, duhet të përmbajnë të dhënat për:
 - 5.1. llojin, përbërjen, karakteristikat, sasinë, origjinën, ruajtjen, transportin, trajtimin, përpunimin, riciklimin, magazinimin dhe deponimin e mbeturinave si dhe mbeturinave të cilat pranohen në objektet dhe pajisjet për menaxhimin e mbeturinave;
 - 5.2. llojin, përbërjen, karakteristikat, sasinë, origjinën, ruajtjen, transportin dhe destinimin e lëndës së parë sekondare të përfituar në objektet për menaxhimin e mbeturinave;
 - 5.3. çështje tjera të rëndësishme.

6. Raporti nga paragrafët 3. dhe 4. të këtij neni plotësohet sipas Shtojcës VI. të Ligjit, dhe në pajtim me aktin nënligjor i cili rregullon kushtet dhe kriteret për raportimin për menaxhimin e mbeturinave.

KAPITULLI IX -BASHKËPUNIMI PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

Neni 31

Bashkëpunimi për menaxhimin e mbeturinave

Të gjitha njësitë përbërëse të komunës dhe administrata komunale, në kuadër të detyrave dhe përgjegjësi të tyre, janë të obliguara të bashkëpunojnë dhe koordinojnë punën ndërmjet tyre për identifikimin e çështjeve të zbatimit të masave dhe gjetjes së mënyrave me efektive për menaxhimin e mbeturinave si dhe për zbatimin e Ligjit, kësaj rregulloreje, legjislacionit në fuqi dhe PKMM-së.

Neni 32

Bashkëpunimi ndër-komunal

Për ushtrimin më efikas dhe më efektiv të menaxhimit të mbeturinave, Komuna e Hanit të Elezit,, kur është interesin publik të tyre, mund të bëjnë marrëveshje për menaxhimin e mbeturinave me një apo më shumë komuna të Republikës së Kosovës në pajtim me format, kushtet dhe procedurat e përcaktuara me Ligjin për bashkëpunim ndërkomunal, dispozitat e të cilit ligj vlejnë edhe për të gjitha format e bashkëpunimit ndër-komunal për menaxhimin e mbeturinave.

Neni 33

Bashkëpunimi me konsumatorët dhe organizatat e shoqërisë civile

1. Organet dhe administrata komunale:
 - 1.1. bashkëpunojnë me konsumatorët dhe organizatat e shoqërisë civile për realizimin e politikave të menaxhimit të mbeturinave, në pajtim me këtë rregullore dhe legjislacionin përkatës në fuqi;
 - 1.2. sigurojnë, inkurajojnë dhe mbështesin pjesëmarrjen e konsumatorëve dhe organizatave të shoqërisë civile në çështjet e menaxhimit të mbeturinave dhe në

- aktivitetet planifikuese dhe zbatuese si dhe u ofrojnë këshilla dhe udhëzime organizatave që kërkojnë të ndërmarrin aktivitete të tilla;
- 1.3. mbajnë komunikime të rregullta me konsumatorët dhe organizatat e shoqërisë civile në mënyrë që të sigurohet një situatë e qartë e menaxhimit të mbeturinave në komunë nga një perspektivë tjetër.

KREU X - MBIKËQYRJA INSPEKTIVE DHE KUNDËRVAJTJET

Neni 34

Mbikëqyrja inspektive

1. Komuna ushtron mbikëqyrjen dhe kontrollin e masave dhe veprimeve gjatë menaxhimit të mbeturinave në territorin e vet, përmes inspektorit komunal për mjedis, në kuadër të përgjegjësisë sipas dispozitave të nenit 62 deri në nenin 69 të Ligjit dhe dispozitave tjera të legjislacionit përkatës në fuqi.
2. Inspektori komunal për mjedis mbikëqyrë dhe inspekton menaxhimin e mbeturinave në objektet, pajisjet dhe hapësirat që gjenden në territorin e komunës, duke ndërmarr masat për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara sipas dispozitave të Ligjit dhe legjislacionit përkatës në fuqi.
3. Inspektori komunal për mjedis, në kuadër të përgjegjësisë është i autorizuar të marrë masa preventive për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut si dhe të shqiptojë gjobë për kundërvajtjet e përcaktuara me Ligj dhe legjislacionin përkatës në fuqi.
4. Punët e inspektorit për mbikëqyrjen inspektive të veprimtarive për menaxhimin e mbeturinave mund t'i kryej edhe zyrtari me kualifikim adekuat të cilin e autorizon komuna në kuadër të përgjegjësisë të veta.
5. Në rastet kur Komuna nuk ka inspektor komunal për mjedis, punët, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, i kryen zyrtari komunal sipas paragrafit 3 të këtij neni, i cili kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e inspektorit komunal për mjedis.

Neni 35

Inspektimi jashtë territorit të komunës

Inspektori komunal për mjedis, sipas marrëveshjes nga neni 15 paragrafi 2, neni 65 dhe neni 67 të Ligjit, mund të mbikëqyrë dhe inspekton menaxhimin e mbeturinave edhe në objektet, pajisjet dhe hapësirat që gjenden jashtë territorit të komunës dhe njëkohësisht Komuna mund të lidhë

marrëveshje që inspektori mjedisor komunal i komunës tjetër të kryejë inspektimin në territorin e Komunës së Hanit të Elezit,

Neni 36

Kundërvajtjet dhe veprat penale

1. Në territorin e Komunës së Hanit të Elezit, kur nuk përbëjnë vepër penale, do të dënohen për kundërvajtje dhe gjobiten me gjoba të përcaktuara, personat fizik, personat juridik dhe personat përgjegjës të personave juridik, për mosrespektim të dispozitave të:

- 1.1. Neneve 71, 73 dhe 74 të Ligjit për mbeturina, dhe
- 1.2. Neneve 137, 138 dhe 139 të Ligjit Nr. 06/L-034 për mbrojtjen e konsumatorit (Gazeta Zyrtare, nr. 11, 14 qershor 2018),
- 1.3. Neneve të ligjeve përkatëse në fuqi.

2. Kur shkeljet e dispozitave të Ligjit për mbeturina dhe legjislacionit përkatës në fuqi përbëjnë vepër penale sipas Kodit Penal, inspektori komunal përmes kryetarit të komunës bënë kallëzimin penal.

Neni 37

Procedurat e ankesës

Kundër vendimit të inspektorit mund të parashtrohet ankesa në pajtim me Ligjin Nr. 05/L -031 për procedurën e përgjithshme administrative (Gazeta Zyrtare, nr. 20, 21 qershor 2016).

Neni 38

Mbeturinat e hedhura nga personi i pa njohur

1. Për tërë mbeturinat e hedhura në hapësira publike ose jashtë deponive të mbeturinave, përgjigjet hedhësi i tyre.

2. Nëse personi përgjegjës për menaxhimin e mbeturinave, në pajtim me përgjegjësitë ligjore, nuk përkujdeset për mbeturinat e hedhura nga personi i pa njohur dhe nuk mund të identifikohet hedhësi, përgjegjësinë për ato mbeturina e bartë Komuna, e cila siguron largimin e tyre.

KAPITULLI XI - DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 39

Përgjegjësia individuale

Çdo person fizik dhe juridik mban përgjegjësi në bazë të dispozitave të kësaj rregulloreje dhe të legjislacionit përkatës për çështjet e menaxhimit të mbeturinave, kur me veprimet ose mosveprimet e tij, ka bërë kundërvajtje dhe shkelje të dispozitave të legjislacionit në fuqi.

Neni 40

Procedura përmbarimore dhe gjyqësore

Ndaj konsumatorëve të cilët nuk bëjnë pagesën e tarifës për mbeturina do të iniciohet procedurë procedura përmbarimore dhe gjyqësore nga njësitë përkatëse të komunës apo nga operatori i kontraktuar për menaxhimin e mbeturinave komunale, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 41

Buxhetimi

1. Financimi i menaxhimit të mbeturinave sigurohet nga pagesat e konsumatorëve, buxheti komunal, Buxheti i Republikës së Kosovës, donacionet dhe burimet tjera financiare në pajtim me legjislacionin në fuqi.
2. Për t'i përmbushur të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në këtë rregullore dhe me legjislacionin përkatës që ka të bëjë me menaxhimin e mbeturinave, organet dhe administrata përkatëse komunale, gjatë fazës së hartimit të buxhetit komunal planifikojnë buxhet për aktivitete të ndryshme që kanë të bëjnë me menaxhimin e mbeturinave si dhe sigurojnë burime njerëzore, financiare dhe logjistike të nevojshme.
3. Komuna e planifikon buxhetin komunal, i cili është transparent dhe bazohet në konsultime me palët.
4. Administrata dhe organet komunale zhvillojnë një proces për analizimin e nevojave të buxhetimit për menaxhimin e mbeturinave, bazuar në procesin e vlerësimit dhe raportimit.
5. Kryetari bashkëpunon me Ministrinë dhe me donator të ndryshëm për prioritetet për marrjen e fondeve për menaxhimin e mbeturinave.

Neni 42

Regjistri i deponive ilegale

Spektori përkatës për Menaxhimin e Mbeturinave, në afat prej gjashtë (6) muajve, pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, duhet të përgatisë regjistrin e deponive ilegale në territorin e Komunës së Hanit të Elezit, sipas dispozitave të Ligjit për mbeturina.

Neni 43
Ngritja e kapaciteteve për menaxhimin e mbeturinave

Për të siguruar ofrimin e një shërbimi cilësor dhe efektiv për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut, të gjithë punonjësit e komunës, veçanërisht punonjësit që kanë përgjegjësi direkte në fushën e menaxhimit të mbeturinave dhe mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit të njeriut, janë të obliguar të ndjekin trajnime dhe aktivitete që synojnë të zhvillojnë kapacitetet e tyre në këtë fushë si dhe të venë në shfrytëzim, në punën e tyre të përditshme, njohurinë dhe dijen e përftuar.

Neni 44
Zbatimi

1. Zbatimit të kësaj rregulloreje në territorin e Komunës së Hanit të Elezit, i nënshtrohen:
 - 1.1. SMM si dhe organet dhe administrata komunale;
 - 1.2. Operatorët e angazhuar për menaxhimin e mbeturinave;
 - 1.3. të gjithë personat fizik dhe juridik, kalimtarët e rastit dhe turistët dhe që ushtrojnë veprimtari dhe që ndodhen në territorin e Komunës;
 - 1.4. Subjektet që ushtrojnë veprimtari ekonomike;
2. Zbatimi i kësaj rregulloreje sigurohet nga Kryetari, me mbështetjen e drejtorit të Drejtorisë së shërbimeve publike dhe/apo udhëheqësit të SMM.
3. Administrata dhe organet komunale janë të obliguara që pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, t'i marrin të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e kësaj rregulloreje dhe kryerjen e të gjitha detyrave dhe përgjegjësi të përkatëse.
4. Për të gjitha rastet që nuk janë të rregulluara me këtë rregullore, zbatohen dispozitat e legjislacionit në fuqi që kanë të bëjnë me menaxhimin e mbeturinave.
5. Kryetari mund të nxjerrë Vendime për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

Neni 45
Interpretimi i Rregullores

1. Kjo rregullore duhet interpretuar dhe zbatuar brenda kuadrit të Kushtetutës, Ligjit për vetëqeverisjen lokale, Ligjit për mbeturina, dhe Statutit të Komunës.
2. Në të gjitha rastet kur ka kundërthënie të kësaj Rregulloreje me Ligjet dhe dispozitat e Statutit të Komunës do të zbatohen dispozitat e ligjeve dhe statutit.

Neni 46
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja Komunale Nr. Protokoli 01/5085/2015 i datës 26.06.2015.

Neni 47
Publikimi

1. Kjo rregullore publikohet në gjuhët zyrtare dhe gjuhët në përdorim zyrtare.
2. Kjo rregullore dhe ndryshimet e mëpasshme të saj publikohen ueb faqen e komunës dhe në “Gazetën Zyrtare”.

Neni 48
Hyrja në fuqi

1. Kjo Rregullore pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ministria përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, publikohet në ueb faqen e komunës.
2. Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në ueb faqen e komunës.
3. Në ditën në të cilën kjo rregullore publikohet në ueb faqe të komunës do të përcaktohet si dita e shpalljes.

Kryesues i Kuvendit Komunal
Florim Shkreta

Nr/ _____ i aprovuar më - - .- - .2023



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



**PROPOZIMET E QYTETARËVE NGA DEBATI PUBLIK ME QYTETARË PËR
RREGULLOREN PËR MENAXHIM E MBETURINAVE NË KOMUNËN E HANIT TË ELEZIT**

Propozimi nga debati publik i z.Ali Axhami:-

1. Propozoj që çmimi për ekonomi familjare të jetë 7 €.



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA - MUNICIPALITY
HANI I ELEZIT



11/Nr-3336/2023

DATA:	18.04.2023
PËR:	Komiteti për Politik e Financa dhe Kuvendin e Komunës
PËRMES:	Kryetarit të Komunës Mehmet Ballazhi <i>M Ballazhi</i>
NGA:	Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural Abduraman Bushi <i>Abduraman Bushi</i>
LËNDA:	Shkresë përcjellëse: Kërkesa e znj. Hanushe Dernjani për ndërrim destinimin e pronës.

Me anë të kësaj shkrese ju përcjellim kërkesën znj. Hanushe Dernjani për ndërrim destinimin e pronës.

Me respekt



REPUBLIKA E KOSOVËS

0101 - Formulari për kërkesë apo ankesë

Drejtoria / Njesia

DBP ZHR

Data

12.06.2023

(dita / muaji / viti)



1 Informatat personale të parashtruesit të kërkesës:

Emri dhe mbiemri

HAUSHE DERNDANI

Lloji dhe numri i dokumentit identifikues

M71515633

Data e lindjes

(dita / muaji / viti)

Adresa e vendbanimit

f.sh. Paldemice

(numri i shtëpisë/banesës, rruga, fshati/qyteti, kodi postar)

Numri i tel. fiks

Numri i tel. mobil

098 771 111

E-mail adresa

Mos shkruani në

këtë pjesë

Pranuar nga:

Numri i protokollit:

M/3152

Vendimi: po jo

Nga: H.E.

Data: 12.06.2023

2 Selektu llojin:

Kërkesë



Ankesë



3 Ju lutemi të shkruani kërkesën apo ankesën tuaj në detaje:

Kerlog nga Drejtoria e DBP ZHR të
më bëj nderim destinimit të
tokës bujqesore në tokë ndërtimore
për parcelën ~~387-0~~ të zonës
kardastrale Paldemice.

Nderim destinimi i tokës të bëhet
me sipërfaqe 700m². -VL-VI-

4 Dëshmia e aplikuesit për vërtetësi

Unë

(Emri i plotë i aplikuesit)

vërtetoj se informatat e lartshënuara janë të vërteta.

(Nënshkrimi)



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Komuna-Municipality
Hani i Elezit

Nr.11/3170/2023

Hani i Elezit, 12.04.2023

R A P O R T

I KOMISIONIT PËR NDËRRIM DESTINIMIN E TOKËS BUJQËSORE NË ATË NDËRTIMORE:

Bazuar në Vendimin **11/3170/2023**, mbi formimin e Komisionit për shqyrtimin e kërkesave për ndërrim-destinimin e pronës nga ajo bujqësore “Arë” e klasit 6 në atë “Ndërtimore”, komisioni ka dalë në vendin e ngjarjes dhe konstatoi:

Vlerësimi i Komisionit:

Z. Hanushe Dernjani (Hafiz), pronar i parcelës **P-73317066-00387-0** më datën **12.04.2023** i ka paraqitur kërkesë me **Nr.11/3170/2023** këtij organi që të bëhet ndërrim destinim të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

Komisioni në vendin e ngjarjes ka dalur më datën **13.04.2023** dhe ka konstatuar se vendi ku kërkohet për ndërrim destinim të kulturës së shfrytësimit të tokës për ndërtimin e një shtalle është pjesë e parceles kadastrale **P-73317066-00387-0**, në sipërfaqe prej **3796m²** me kultur “Arë” klasa 6, në vendin e quajtur “Zelishte”, që evidentohet në Çertifikatën e Pronësis parcelë nr.387-0 në zonën kadastrale Paldenicë në pronësi të **Hanushe Dernjani (Hafiz)** nga fshati Paldenicë- Hani i Elezit. Pjesa e kërkuar është **ndërtimi i një Shtalle me sipërfaqe 700m²**,

Bazuar në të gjitha këto fakte komisioni vlerëson se është i mendimit që ti ipet pëlqimi njëherë vetëm për ndërrim destinim të tokës bujqësore në atë ndërtimore të shtallës me sipërfaqe **700m²**.

Këti raporti i bashkangjesim edhe Kopjen e planit dhe një Çertifikat prone.

Ky vlerësim i komisionit vlenë për vazhdimin e procedurave të mëtutjeshme, për dërgim të lëndës për shqyrtim dhe miratim në Kuvend Komunal në mbledhjet që do të mbahen gjatë muajve në vazhdim.

Komisioni i përbërë nga :

1. Remzi Bushi,

2. Amir Berisha,

3. Enver Thaçi,





Republika e Kosovës

Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-73317066-00387-0

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:

Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:

Komuna / Opština / Municipality:

Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:

Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:

06-941/01-3127/2023

12.04.2023 - 10:31

HANI I ELEZIT / ELEZ HAN / HANI I ELEZIT

Paldenicë / Palivodenica / Paldenicë

HANI I ELEZIT / ELEZ HAN / HANI I ELEZIT

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësies kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësies Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-73317066-00387-0	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë private / Privatna Imovina / Privately owned Land		3796			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
ZALISHTE				



A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja Površina Area (m²)
1	Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture	Ara/Njive/Arable	Arë E Klasës 6/Njiva 6 Klase/6th Class Arable Land	3796

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojedinositi adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	DERNJANI HANUSHE (HAFIZ)	1171515633	PALDENICË / PALJIVODENICA / PALDENICË /			1/1	Kontratiç mbi dhurimin e paluajtshmerisë Vr.nr.171/2021 dt.01.09.2021 Aktvendim i DUKMM-së Protokoll 06-941/01-7388/2021	08.10.2021



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : HANI I ELEZIT

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Paldenicë

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-73317066-00387-0	Parcelë / Parcela / Parcel	3796



Shkalla/Razmera/Scale: 1:612

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 12.04.2023

Koha/ Vreme/ Time: 10:33:21

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note: Protokol: 3128/2023

Aprovoi/Usvojio/Approved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature:







Republika e Kosovës - Republic of Kosovo
Komuna – Municipality
Hani i Elezit



05/Nr. 3105 2023

DATA	07.04.2023
PËR	KPF dhe Kuvendin e Komunës
PËRMES	Mehmet Ballazhi Kryetari i Komunës
NGA	Hisni Luri Drejtore për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport
LËNDA	Informatë mbi raportin e Komisionit për ndarjen e bursave për vitin shkollor 2022/2023

Të nderuar,

Bazuar në Ligjin mbi Vetëqeverisjen Lokale me Nr. 03/ L-040, Neni 11 dhe 12.1, Statutit të Komunës së Hanit të Elezit, Neni 63 dhe në bazë të Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve me Nr. 01/ 2821/ 2022 të datës 31.02.2022 dhe në konkursin e shpallur nga DKA-ja të datës 28.02.2023, ju dërgojmë informatën për ndarjen e mjeteve financiare për bursa për studentët e Komunës së Hanit të Elezit për vitin shkollor 2022/2023.

Me respekt

Drejtore për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport
Hisni Luri



RAPORT I NDARJES SË BURSIVE PËR STUDENT PËR VITIN AKADEMIK 2021/2022

Komuna Hani i Elezit përkatësisht Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport bëri thirrjen publike (konkurs) për aplikim e bursave për studentë për vitin shkollor 2022/2023, të datës 28.02.2023.

Pas përfundimit të konkursit, formohet komisioni në nivel të Administratës së Komunës për ndarjen e bursës për studentët që kanë konkuruar për fitimin e bursës në vitin shkollor 2022/2023, në konkursin e shpallur nga Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport.

Komisioni:

1. Sear Dernjani - Shef i Arsimit në DKA- Kryetar i Komisionit
2. Vjosa Rogaqi – Zyrtare Ligjore (anëtare)
3. Selver Shkreta - Zyrtar Financiar (anëtarë)

Komisioni ka shqyrtuar dhe ka hartuar listën, të radhitur sipas pikëve, të cilën listë e kemi publikua më datën më: 31/03/2023

Ne si drejtori bazuar në rregulloren e ndarjes së bursave këtë vit janë ndarë 40 bursa duke përfshirë edhe studentët nga Republika e Maqedonisë Veriore.

Aplikantët (studentët) që kishin aplikuar për bursa ishin (59), 40 nga ta janë përfutues të bursave në komunë.

Të bashkangjitur e keni edhe listë bashkangjitur e keni edhe listën e plotë dhe pikët për secilin student.



Nr. 0512865 2023

Komisioni për ndajjen e bursave i formuar nga Kryetari i Komitëut të Komunës në datën 15.03.2023, shqyrtuan dokumentet e studentëve që kanë aplikuar për bursë në bazë të Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat për ndajjen e Subvencioneve me Nr. 02/ 28.1/2022 të datës 31.05.2022 dhe konkursit të shpallur me Nr. 02/1664/2023, Komisioni bëri përzgjedhjen e 40 - (katërdhjetë) studentëve të poshtëshënuar:

LISTA E STUDENTËVE TË PËRZGJEDHUR NGA KOMISIONI PËR NDARJEN E BURSAVE PËR VITIN 2022/23

[illegible]



Republika e Kosovës-Republic of Kosovo
Ndërmarrja Publike Lokale
"PASTRIMI" SH.A
Hani Elezit



01/Nr. 3108/2023

Data:	06.04.2023
PËR:	KPF dhe Kuvendin e Komunës së Hani të Elezit
PËRMES:	Kryesuese e Komisionit të Aksionerëve – znj. Sevim Bajrami
NGA:	Ndërmarrja Publike Lokale e Mbeturinave - NPL "PASTRIMI" SH.A
LËNDA:	Informatë mbi Raportin Janar – Mars 2023

Të nderuar anëtarë të KPF-së dhe Kuvendit të Komunës

Me anë të këtij raporti, ju përcjellim informatën për raportin financiar Janar - Mars 2023, për Ndërmarrjen Publike Lokale të Mbeturinave - Npl "Pastrimi" Sh.a.

Me respekt,



Republika e Kosovës-Republic of Kosovo
Ndërmarrja Publike Lokale
"PASTRIMI" SH.A
Hani i Elezit



Nr.Prot.32/2023

Data:	06.04.2023
PËR:	KPF dhe Kuvendin e Komunës së Hanit të Elezit
PËRMES:	Kryesuese e Komisionit të Aksionarëve – znj. Sevime Bajrami
NGA:	Ndërmarrja Publike Lokale e Mbeturinave - NPL "PASTRIMI" SH.A
LËNDA:	Informatë mbi raportin për periudhën Janar – Mars/2023 Npl "Pastrimi" Sh.a

Të nderuar anëtarë të KPF-së dhe Kuvendit të Komunës

Me anë të këtij raporti, ju përcjellim informatën për periudhën Janar - Mars/2023 për Ndërmarrjen Publike Lokale të Mbeturinave - Npl "Pastrimi" Sh.a.

Informatë mbi raportin Janar - Mars / 2023 të NPL "PASTRIMI" SH.A

Me respekt.

RAPORTI PËR PERIUDHËN JANAR – MARS / 2023, I NDËRMARRJES PUBLIKE LOKALE TË MBETURINAVE - NPL"PASTRIMI" SH.A

Ky raport është përgatitur për periudhën Janar – Mars / 2023, në bazë të ligjit për Ndërmarrjet Publike - Ligjit Nr.03/L-087, të nenit 31 dhe nenit 14, paragrafit 14.2 dhe Statutit të Ndërmarrjes Publike Lokale "Pastrimi" Sh.a. Ndërmarrja Publike Lokale – NPL "PASTRIMI" SH.A, bënë menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunësse Hanit të Elezit, ku përfshihen të gjitha lokalitetet e Komunës.

Ndërmarrja Publike Lokale – Npl"Pastrimi"Sh.a, ka gjithësej nëntëmbëdhjetë punëtor(19) punëtorë të rregullt dhe dy punëtor me kontratë për "kohë të caktuar"si vijon:-

- 1 Kryeshef Ekzekutiv
- 1 Sekretar i Ndërmarrjes
- 1 Zyrtar i Lartë Financiar–Thesarë
- 1 Arkëtare
- 1 Zyrtar i Prokurimit
- 1 Inkasant
- 3 Shofer
- 3 Punëtor teknik
- 9 Pastrues (Grumbullues të mbeturinave)

Sa i përket kësaj periudhe Janar – Mars 2023, mund të themi se gjatë kësaj periudhe ka qenë një periudhë me shumë punë dhe aktivitete nga punëtorët e ndërmarrjes publike lokale "Pastrimi". Gjatë kësaj periudhe punëtorët e kompanisë kanë qenë të angazhuar në terren në kryerjen e shërbimit të mbeturinave dhe njëkohësisht kanë kryer pastrimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve në qendër të Hanit të Elezit, pastrimin e rrugëve në fshatra përreth, pastrimin dhe mirëmbajtjen e varrezave të dëshmorëve në Pustenik, krasitjen e pemëve dekorative në qendër të Hanit të Elezit etj.

Në muajin Shkurt kanë qenë të angazhuar në vendosjen e flamujve shtetëror në vende publike për nderë të ditës së 17 Shkurtit, ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, gjithashtu në këtë muaj kemi nënshkruar një kontratë me ipkon për ofrimin e shërbimeve të telefonisë mobile, kjo kontratë është nënshkruar për periudhën gjashtëdhjetë (60) mujore.

Në mars ndërmarrja publike lokale "Pastrimi" dhe zyra e punësimit, dega në Hani i Elezit kanë nënshkruar një marrëveshje mirëkuptimi për pranimin e një punëtori me kontratë pune për kohë të caktuar për gjashtë (6) muaj, të cilin e paguan zyra e punësimit në lartësi prej 70% të pagës mujore, ndërsapjesën tjetër e paguan Npl-ja dhe një punëtor tjetër të cilin e paguan Npl "Pastrimi". Gjatë muajit mars kemi vazhduar marrëveshjen edhe për një (1) vit me fabrikën e çimentos Sharrcem për kryerjen e shërbimit të mbeturinave. Në muajin mars tre punëtor kanë ndërprerë kontratën e punës me vullnetin e tyre me Npl"Pastrimi", për arsye të punësimit të tyre në një sektor tjetër publik. Bordi i Drejtorëve i Npl "Pastrimit" në mbledhjen e mbajtur në muajin mars, me iniciativën e kryeshefit ekzekutiv të kompanisëz.HirmanKukasë bashku kanë propozuar ndryshimin e çmimit të shërbimit të mbeturinave, i cili është përcjellë për votim në kuvendin komunal nga fundi i muajit mars.

Lista e punëtorëve të NPL-së, pozita e vendit të punës dhe paga e tyre si vijon:-

Nr.	Pozita	Nr. Punëtorëve	Paga Bruto
1	Kryeshefi Ekzekutiv	1	682.5
2	Zyrtari i Lartë Financiar - Thesarë	1	423.85
3	Sekretar i Ndërmarrjes	1	423.85
4	Arkëtare	1	423.85
5	Shofer	2	362.5
6	Shofer – mbykqyres i punëtorve në teren	1	423.85
7	Inkasant	1	362.5
8	Grumbullues i mbeturinave	9	303.01
9	Punëtor teknik	3	303.01
10	Zyrtar i prokurimit	1	120
11	TOTALI I STAFIT TË NPL-SË	21	

Gjatë periudhës Janar – Mars /2023, janë mbajtur tre (3) mbledhje me Bordin e Drejtorëve të Npl "Pastrimi" Sh.a.

Çmimet e kontratave janë:-

- Kontratë familjare **5€**, në muaj,
- Kontratë e mesme **8€**, në muaj,
- Kontratë me zbrazje **13€**, për çdo zbrazje të kontenjerit **1100L**.

Gjatë periudhës Janar– Mars /2023 janë nënshkruar disa kontrata me klient të rinj të Npl"Pastrimi" Sh.a, ato janë:-

- Kontratë familjare **3**,
- Kontratë biznesore **2**,
- Institucionale **0**.

Totali i kontratave të nënshkruara nga viti 2017 –Mars / 2023 janë si vijon:-

- Ekonomitë familjare ----- **1468**
- Kontratë biznesore ----- **97**
- Kontratë institucionale ----- **10**
- Totali i kontratave ----- **1575**

1. Hyrje

Raporti financiar për periudhën Janar – Mars2023, është përgatitur në bazë të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, të nenit 14, paragrafët 14.2 si dhe statutit të Ndërmarrjes Publike Lokale.

Ky raport përmban një përmbledhje të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore te kompanisë së mbeturinave përgjatë periudhës Janar – Mars 2023. Raporti pasqyron të hyrat e kompanisë, si dhe krahasimet me periudhë paraprake.

1.1. Performanca e të hyrave nga shërbimet

Të hyrat nga shërbimet kanë arritur vlerën e 44.111 euro duke shënuar rrënje me 1.05 % që korrespondon me 468.8euro më pakë krahasuar me të hyrat e vitit 2022.

Performanca e shpenzimeve te kompanisë

Shpenzimet e kompanisë kanë arritur vlerën prej 46,217.26euro duke shënuar një rritje prej 0.7 % që korrespondon me 340.62 euro më shumë krahasuar me vitin paraprak.

- Shpenzimet për paga dhe mëditje shënuan vlerën e 29,484.45 € duke shënuar një rritje prej 2,082.09 € apo 7.6% krahasuar me vitin 2022.
- Shpenzimet në tatime janë 0 në të dy tremujorët,
- Shpenzimet për mallra dhe shërbime shënuan vlerën prej 16,732.81 € duke shënuar një rrënje1,741,46€ apo 9.4 % krahasuar me vitin 2022.
- Shpenzimet komunale janë 0 në të dy tremujorët,
- Shpenzimet Kapitale – janë 0.

2. TË HYRAT E KOMPANISË

	TE HYRAT	2022	2023	Krahasimi
1	Të hyrat nga Shërbimet	44,579.80	44,111.00	(468.80)
2	Paraja në bankë	1,127.60	2,046.46	918.86
	TOTALI	45,707.40	46,157.46	450.06

3 SHPENZIMET E KOMPANISË

3.1 PAGAT DHE MEDITJET

A	PAGAT DHE MEDITJET	2022	2023	Krahasimi
1	PAGAT NETO + SHUJTA	22,619.27	24,902.82	2,283.55
2	KONTRIBUTI I PUNEMARRSIT	1,184.25	1,326.00	141.75
3	KONTRIBUTI I PUNEDHENESIT	1,184.25	1,326.00	141.75
4	TATIMI NE BURIM	1,014.59	999.63	(14.96)
5	MEDITJET E BORDIT	1,400.00	930.00	(470.00)
	TOTALI	27,402.36	29,484.45	2,082.09

3.2 MALLRA DHE SHËRBIME

C	MALLRA DHE SHËRBIME	2022	2023	Krahasimi
1	Shpenzime për karburant	10,088.14	6,236.51	(3,851.63)
2	Shpenzimet e deponisë (KMDK)	3,457.63	959.90	(2,497.73)
3	Shpenzimet për internet	99.90	75.00	(24.90)
4	Shpenzimet e Mirëmbajtjes se Mjeteve	2,181.00	4,712.10	2,531.10
5	Furnizim me Rërë I II III	180.00		(180.00)
6	Shpenzime për Softuer Kompjuterik	400.00		(400.00)
7	Shpenzime per zyre dhe administrative	-	1,465.00	1,465.00
8	Shpenzime për zyre pajisje dhemjete pune	582.45	631.10	48.65
9	Shpenzime për trajnime	90.00		(90.00)
10	Shpenzimet e Reprerentacionit	327.00	91.00	(236.00)
11	Shpenzimet e Sigurimit	706.86		(706.86)
12	Shpenzime Telefoni - (Mbushje)	130.00	99.00	(31.00)
13	Provizione Bankare NLB BANK	33.30	38.20	4.90
14	Çertifikata për shofer kamioni			-
15	Çertifikatashëndetsore			-
16	Licence		500.00	500.00
17	Uniforma pune		1,925.00	1,925.00
18	Shpenzime Higjienike	198.00		(198.00)
	TOTALI	18,474.28	16,732.81	(1,741.47)

3.3 TATIME

B	TATIMET	2022	2023	Krahasimi
1	TVSH-ja 8%	-	-	-
2	KESTET TREMUJORE (ATK)	-	-	-
3	TATIMI VJETOR MBI KORPORATA	-	-	-
	TOTALI	-	-	-

3.3 SHPENZIME KOMUNALE

D	Shpenzime Komunale	2022	2023	Krahasimi
1	Shpenzimet e Rrymes	-	-	-
				-
	TOTALI	-	-	-

3.4 SHPENZIME KAPITALE

E	Shpenzime Kapitale	2022	2023	Krahasimi
1	Blerje e Kamionit për mbeturina	-	-	-
				-
	TOTALI	-	-	-

4 TOTALI I TË HYRAVE DHE SHPENZIMEVE

	TE HYRAT	2022	2023	Krahasimi
1	Të hyrat nga Shërbimet	44,579.80	44,111.00	(468.80)
2	Paraja në bankë	1,127.60	2,046.46	918.86
	TOTALI	45,707.40	46,157.46	450.06
	SHPENZIMET			
	Shpenzime Tjera A+B+C+D+E	45,876.64	46,217.26	340.62
	Fitimi/Humbja	(169.24)	(59.80)	109.44

5 TOTALI I TË HYRAVE DHE SHPENZIMEVE

- Llogari të Arkëtueshme (Borgje) 33.191.45
- Llogari të Pagueshme (Detyrime) 9,135.08